



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Luarasi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Etleva Refatllari
2. Prof. Asc. Nevila Heta

Dhjetor/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Infermieri” ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Lartë “Universiteti Luarasi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Luarasi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhëri MASR Nr. 281, datë 28.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë) në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/ 27 PAK v.a. 2021-2022 17 PAE/ 17 PAK v.a. 2022-2023 19 PAE/ 22 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	107 studentë v.a. 2021-2022 127 studentë v.a. 2022-2023 96 studentë v.a. 2023-2024
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës


Universiteti “Luarasi” (UL) është institucion jopublik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë me eksperiencë 21 vjeçare në fushën e arsimit, i licencuar si Kolegj Universitar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë 11.09.2003. Kolegji Universitar Luarasi u riorganizua në Universitetin Luarasi në zbatim të vendimit Nr. 494 datë 10.11.2019 dhe sot prezantohet i organizuar në katër fakultete (Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i teknologjisë së informacionit dhe inovacionit dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore) që ofrojnë 17 programe studimi. UL ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 115, datë 15.12.2017 për një periudhë 6 vjeçare dhe është në procesin e riakreditimit institucional.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UL është hapur me urdhër të MASR Nr. 169, datë 22.06.2021. Ai përbëhet nga Departamentet e Stomatologjisë, Farmacisë dhe Infermierisë. Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të UL. Ai u miratua si program i ciklit të parë të studimeve me urdhërin e MASR Nr. 281, datë 28.07.2021. Ky program është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Departamentit të Infermierisë që është përgjegjës për këtë program studimi.

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloret e institucionit, Ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ” si dhe akteve nënligjore në fuqi për IAL-të. Ai është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Programi zhvillohet me kohë të plotë, organizohet në lëndë e module të vlerësuara në ECTS. Programi ka një shtrirje në 3 vite akademike (6 semestra) dhe vlerësohet me 180 ECTS të shpërndara uniformisht gjatë 3 viteve.

Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit Bachelor në “Infermieri” përmbush përgjithësisht kërkesat ligjore, standartet e cilësisë së stafit akademik dhe standartet infrastrukturorë për ofrimin e tij.

Programi synon të përgatisë infermierë të aftë për të përmbushur nevojat e sistemit shëndetësor në Shqipëri duke integruar përgatitjen profesionale me edukimin e vlerave si fryma e bashkëpunimit, etika profesionale, përgjegjësia sociale, integriteti njerëzor dhe profesional, respekti, llogaridhënia, përgjegjësia, diversiteti. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës vendas dhe më gjerë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Bachelor në “Infermieri”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UL. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit; Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat; Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen
- Standardet përmbushen pjesërisht
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Dokumentacioni i referuar listohet për çdo kriter dhe standard (Evidencat).

Proçesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Etleva Refatllari dhe Prof. Asc. Nevila Heta. Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proçes vlerësimi është Msc. Muhamed Prezja.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, proçesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UL e zhvilluar në datat 20 – 21 Qershor 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.



Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UGJ.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

GVJ me datë 25.11.2024 dërgoi draftin e parë të raportit të vlerësimit të jashtëm dhe institucioni me datë 06.12.2024 dërgoi komentet e saj rreth këtij drafti. GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit shprehet si më poshtë:


Nga leximi i kujdesshëm i komenteve, vërejmë që konstatimet tona të shënuara në raport, janë pranuar në përgjithësisht nga institucioni. Komentet e bera mbi to shpjegojnë rastet kur gjetja jonë lidhet me gabim njerezor apo shpjegojnë hapat që janë marrë apo do të merren për korigjimin në vijim.

Kemi disa ndryshime lidhur me konstatimet në standardin II, të cilat megjithatë, nuk ndikojnë në vlerësimin e përgjithshëm të këtij standardi.

- Standardi II/1 Kriteri 1, GVJ ka paraqitur në forme tabelare të dhënat e evidencës 25 dhe ka analizuar kriterin 1 bazuar në keto të dhëna. Konstatimi ynë për papërputhshmërinë me tabelat e RVB-së nuk ka ndikuar në vlerësimin tonë pasi e kemi marrë në konsideratë “gabimin njerezor”.
- Standardi II/1 Kriteri 3, Duke reflektuar mbi komentin e institucionit mendojmë të hiqet nga komenti ynë në fund të këtij kriteri shprehja: “Infermiera Klinike, lëndë karakterizuese B, nuk gjendet në planin mësimor në asnjë prej viteve të studimit. Në planin mësimor ka dublikime lëndësh sic është rasti i fiziologjisë normale”.
- Standardi II/1 Kriteri 7, Në fund të këtij kriteri të hiqet shënimi “në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCL nuk evidentohet shkresa e QSHA per kodin e programit te studimit” dhe të zëvendësohet me “programi i studimit është i kodifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe mban kodin 63BA0913S”.

GVJ shprehet se nuk ka ndryshime apo shpjegime të mëtejshme për komentet e standardeve III dhe IV.

Raporti merr formën e vet finale si më poshtë.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti “Luarasi” (UL) është institucion jopublik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë me eksperiencë 21 vjeçare në fushën e arsimit. UL është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë 11.09.2003. UL u hap fillimisht si një institucion i dedikuar në programet e fushës së Drejtësisë. Gjatë 20 viteve të funksionimit UL ka zgjeruar kapacitetet logjistike dhe akademike duke shtuar ofertën akademike dhe në fusha të tjera si ekonomia, teknologjia e informacionit dhe mjekësia. Në vitin 2019, në zbatim të vendimit Nr. 494 datë 10.11.2019, Kolegji Universitar Luarasi u riorganizua në Universitetin Luarasi. Aktualisht UL është organizuar në 4 fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none">• Fakulteti i Drejtësisë• Fakulteti Ekonomik• Fakulteti i teknologjisë së informacionit dhe inovacionit• Fakulteti i Shkencave Mjekësore <p>UL ofron në tërësi 17 programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none">• 3 programe të integruara të ciklit të dytë• 5 programe Bachelor• 5 programe Master i Shkencave• 4 programe Master Profesional <p>UL ka marrë akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 115, datë 15.12.2017 për një periudhë 6 vjeçare dhe është në procesin e riakreditimit institucional.</p> <p>UL deklaron në statut se organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi. Në frymën e statutit dhe ligjit të arsimit të lartë të cituar më sipër, institucioni ka hartuar rregulloret e funksionimit në bazë të të cilave organizohet programi i studimit Bachelor në “Infermieri”, Rregulloren e UL, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UL janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë.</p>



	<p>Vizioni i Universitetit “Luarasi” (siç prezantohet në faqen ëeb të UL) është krijimi i një universiteti model ekselence, lider në zhvillimin e qëndrueshëm të dijes në Shqipëri e rajon. Ky vizion synon ta shndërrojë këtë institucion në vatër të kultivimit të vlerave më të mira në funksion të formimit të elitës së profesionistëve të së ardhmes. UL ka marrë përsipër t’u ofrojë studentëve dhe shoqërisë një qendër edukimi që integron plotësisht tre drejtimet bazë të procesit akademik: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe përgjegjësinë sociale. Këto përgjegjësi janë në përputhje të plotë si me prioritetet e zhvillimit të vendit ashtu edhe me sfidat globale të shekullit që po jetojmë.</p> <p>Misioni i Universitetit “Luarasi”, i sanksionuar në statutin dhe rregulloret e tij është të krijojë dhe të zhvillojë dije të qëndrueshme përmes mësimdhënies e mësimnxënies cilësore, integritit me praktikën, nxitjes së kurajës dhe kërkimit shkencor për formimin e profesionistëve elitare e me etikë të lartë profesionale, konkurues të denjë në tregun e punës vendas e më gjerë.</p> <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 2-Rregullore e UL, 9-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”, Guida e studentit në faqen ëeb të UL)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UL funksionon që nga viti 2021. Ai është hapur me urdhër të MASR Nr. 169, datë 22.06.2021 dhe përbëhet nga 3 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Stomatologjisë • Departamenti i Farmacisë • Departamenti i Infermierisë <p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ofrohet nga Departamenti i Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të UL. Ai u miratua si program i ciklit të parë të studimeve me urdhërin e MASR Nr. 281, datë 28.07.2021. Programi i studimit Bachelor “Infermieri” kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Programi synon të pregatisë infermierë të aftë për të përmbushur nevojat e sistemit shëndetësor në Shqipëri duke integruar pregatitjen profesionale me edukimin e vlerave si fryma e bashkëpunimit, etika profesionale, përgjegjësia sociale, integriteti njerëzor dhe profesional, respekti, llogaridhënia, përgjegjësia, diversiteti. Në funksion të këtij misioni institucioni ka përpiluar objektivat strategjike të zhvillimit që fokusohen në tre shtylla kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimin institucional: rritjen e kapaciteteve dhe performancës akademike në mësimdhënie, rritjen e kapaciteteve infrastrukture, rritjen dhe diversifikimin e ofertës akademike, digitalizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkimin shkencor: përmes partneritetit, projekteve dhe këmbimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. • Zhvillimin e jetës studentore. <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Infermieri", 13-Plani strategjik i zhvillimit të UL 2021 – 2025)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>UL dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, ofruet të programit të studimit Bachelor në "Infermieri" e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit dhe strategjitë e zhvillimit. Institucioni ka publikuar dokumentin e strategjisë së zhvillimit për vitet 2021 – 2025 ku pasqyrohet vizioni i UL për politikën afatmesme dhe afatgjatë në mësimdhënie dhe përvetësim dijes. UL përcakton si mision krijimin e një universiteti në shërbim të vlerave më të larta njerëzore, promotor të zhvillimeve në territor, me shërbime cilësore dhe të integruara në të gjithë Shqipërinë. UL synon t'u japë studentëve një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve të dijes e shkencës, partneritetit me tregun e punës dhe faktorët ndërkombëtarë. Në nenin 4 të Rregullores së programit të studimit theksohet se Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri, me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në UL dhe Departamentit të Infermierisë që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" synon t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e infermierisë. Programi synon gjithashtu edukimin e vlerave etike dhe njerëzore të domosdoshme për rritjen e cilësisë së shërbimit mjekësor.</p> <p><i>(Evidencat 13-Plani strategjik i zhvillimit të UL 2021 – 2025, 1-Statuti i UL, 8-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, 18-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Infermieri")</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi Bachelor në "Infermieri" është një program relativisht i ri në Universitetin Luarasi, megjithatë GVJ konstaton se ky program ofrohet në një institucion me traditë në mësimdhënie që ka angazhuar kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike përkatëse për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i GVJ u mbështet në konsultimin e dokumentacionit të dorëzuar, në takimet me stafin dhe vizitën në ambientet e mësimdhënies. Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe në CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor</p>

“Infermieri”. Nga verifikimi i të dhënave rezulton se në përgjithësi institucioni ka përvojë dhe kapacitete akademike për ofrimin e programit të studimit dhe bën përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e stafit. FSHN përgjegjës për programin e studimit Bachelor “Infermieri-Mami” ka tre departamente:

1. Departamenti i Stomatologjisë
2. Departamenti i Farmacisë
3. Departamenti i Infermierisë

Në këtë fakultet aktivizohen një numër optimal personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si dhe personel ndihmës akademik (PNA), specialistë të fushave që mbulon secili departament:

1. Viti akademik 2023 – 2024
 - a. PAE 27, të kategorive: 5 Prof., 3 Prof. Asc., 14 Dr., 5 Msc.
 - b. PAK 47, të kategorive: 9 Prof., 7 Prof. Asc., 23 Dr., 8 Msc.
 - c. PNA 5
2. Viti akademik 2022 – 2023
 - a. PAE 25, të kategorive: 6 Prof., 6 Prof. Asc., 12 Dr., 1 Msc.
 - b. PAK 58, të kategorive: 8 Prof., 8 Prof. Asc., 19 Dr., 23 Msc.
 - c. PNA 5
3. Viti akademik 2021 – 2022
 - a. PAE 24, të kategorive: 8 Prof., 4 Prof. Asc., 10 Dr., 2 Msc.
 - b. PAK 40, të kategorive: 5 Prof., 4 Prof. Asc., 12 Dr., 19 Msc.
 - c. PNA 5

Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë dhe infermierisë të shpërndarë në vite si më poshtë.

1. Viti akademik 2023 – 2024
 - a. PAE 11, të kategorive: 1 Prof., 2 Prof. Asc., 3 Dr., 5 Msc. (1 në proces Doktorature)
 - b. PAK 19, të kategorive: 3 Prof., 2 Prof. Asc., 9 Dr., 5 Msc.
 - c. PNA 2
2. Viti akademik 2022 – 2023
 - a. PAE 9, të kategorive: 1 Prof., 3 Prof. Asc., 4 Dr., 1 Msc. (në proces Doktorature)
 - b. PAK 30, të kategorive: 4 Prof., 1 Prof. Asc., 7 Dr., 18 Msc. (1 në proces Doktorature)
 - c. PNA 2
3. Viti akademik 2021 – 2022
 - a. PAE 8, të kategorive: 2 Prof., 2 Prof. Asc., 2 Dr., 2 Msc. (1 në proces Doktorature)
 - b. PAK 23, të kategorive: 4 Prof., 2 Prof. Asc., 9 Dr., 8 Msc.
 - c. PNA 2

Institucioni ka kapacitetet infrastrukurore (laboratorë, mjete audiovizuale, auditorë) për zhvillimin e programit të studimit. ***GVJ konstatoi se institucioni nuk ka një laborator të dedikuar***

	<p><i>infirmieristike. Në diskutim me stafin akademik dhe studentët GVJ u informua se praktikat e infirmieristikës zhvillohen në laboratorët e tjerë dhe në auditor si dhe në institucionet me të cilat UL ka marrëveshje bashkëpunimi.</i></p> <p>Institucioni ka marrëveshje aktive bashkëpunimi me poliklinika dhe spitale publike dhe private për realizimin e praktikave profesionale. Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e bibliotekës që u vizituan nga GVJ.</p> <p><i>(Tabelat 1, 6, 7, 8, 16, 17 të RVB, Evidenca 17-Raporti vjetor për vitin akademik 2021 – 2022, 2022 – 2023, CV e personelit akademik, vizita dhe takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infirmieri” është program që përgatit profesionistë të mjekësisë me fushë veprimi në shërbimin infirmieror. Programi ka mision formimin e studentëve me njohuritë më të mira për ushtrimin e profesionit të infirmierit por dhe krijimin e mundësive për thellimin e studimeve në programet e ciklit të dytë Master Profesional apo Shkencor në fushën e infirmierisë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përputhet plotësisht me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Departamentit të Infirmierisë, përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Infirmieri” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi kategorizohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve • Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit • Strukturohet në 6 semestra akademikë (secili me 30 ECTS) • Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018, i përditësuar) • Programi i studimit është i kodifikuar në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin: Kodi i programit është 63BA0913S • Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 8-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, 18-Rregullore e Departamentit të Infirmierisë, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Infirmieri”, 19-Shkresa e UL Nr. 76 datë 29.03.2023 për kodifikimin e programeve të ofruara nga UL)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor në “Infirmieri” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Departamentit të Infirmierisë që janë përgjegjëse për këtë program</i></p>



	<p><i>studimi. Programi i studimit synon formimin e specialistëve të aftë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të ofruar kujdes shëndetësor në fushat e parandalimit, trajtimit dhe edukimit shëndetësor të popullatës.</i></p> <p><i>Programi synon të pregatisë studentët me kapacitete të mjaftueshme teoriko-praktike për të vazhduar studime të mëtejshme dhe kërkim shkencor. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel dhe kujdes infermieror/mami.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UL ofron 3 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e kujdesit shëndetësor. Departamenti i Infermierisë është departamenti përgjegjës për programin Bachelor në “Infermieri”.</p> <p>Për realizimin e këtij programi departamenti ka angazhuar PAE dhe PAK. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i UL. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidial dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit.</p> <p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit.</p> <p>Aktet rregullatore janë statuti dhe rregulloret e datajuara te institucionit, njësisë kryesore, njësisë bazë dhe rregullorja e programit të studimit. Institucioni ka ndërtuar planin strategjik të zhvillimit realizimi i të cilit monitorohet nga strukturat drejtuese të tij. Për realizimin e programit të studimit institucioni ka lidhur gjithashtu marrëveshje me institucione mjekësore për realizimin e praktikave mësimore. Dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njësisë bazë të FSHM si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi.</p> <p>Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe raportin vjetor institucional. NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes</p>

	<p>grumbullimit dhe analizimit të informacionit mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit akademik.</p> <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 2-Rregullore e brendshme e UL, 8-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, 18-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”, 20-Analiza e Departamentit të Infermierisë për programin Bachelor në Infermieri 2021-2022, 2022-2023, 21-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin praktikave mësimore dhe profesionale, Tabelat 3 dhe 5 të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Infermieri”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione spitalore dhe të kujdesit shëndetësor primar publike dhe private si dhe me institucione homologe jashtë vendit. Po ashtu institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dhe akademinë Dekra. Veç përmbushjes së detyrimeve për plotësimin e programit mësimor, institucioni synon që përmes angazhimit të studentëve në këto institucione t’iu krijojë mundësi për t’u orientuar në tregun e punës dhe për të vlerësuar prioritetet në fushën e profesionit të infermierit.</p> <p>Në takimin me stafin dhe studentët GVJ u informua se në kuadër të marrëveshjeve Erasmus+ ka patur mobilitet të stafit (1 pedagog) dhe studentëve të këtij programi (2 studentë) në një universitet në Varshavë, Poloni. Studentët dhe stafi u shprehën shumë entuziastë për bashkëpunimin me Michels Kliniken GmbH&CoKG. Studentët referuan eksperiencën e përfituar gjatë trajnimit të shkurtër në këtë institucion.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ marrëveshjet si dhe korrespondencën me institucionet mjekësore për realizimin e praktikës profesionale për studentët.</p> <p><i>(Evidencat 21-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin praktikave mësimore dhe profesionale, 22-Marrëveshje bashkëpunimi me Michels Kliniken GmbH&CoKG, Tabela 5 e RVB, takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi Bachelor në “Infermieri” është një program i gjerë, i dedikuar i kujdesit shëndetësor që pajis studentin me aftësi për ndërhyrje terapeutike, rehabilituese dhe parandaluese në fusha të ndryshme të asistencës mjekësore si mjekësi e përgjithshme, kirurgji etj. Pë realizimin e praktikës shumëplanëshe në funksion të programit UL ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore universitare publike (QSUT, Spitali Universitar i Traumës), disa poliklinika dhe OSHKSH si dhe disa institucione private të kujdesit shëndetësor (klinikat Akili, Hipokrati, Genius, Intermedika, Amavita etj). Në takimin me stafin GVJ u informua se praktika zhvillohet me një plan të detajuar në mënyrë që studenti të plotësojë të gjithë</p>

	komponentët e ndërhyrjeve infermieristike në seancat e planifikuara. Praktika koordinohet nga departamenti dhe pedagogët përkatës. <i>(Evidenca 21-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale, takimet në institucion)</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në mënyrë periodike, njësia kryesore, përgjegjëse e programit të studimit harton raporte analitike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në raportet periodike të FSHN dhe UL vihet theksi tek arritjet akademike të stafit, publikimet, mobiliteti dhe aktivitetet e konferencat e organizuara. Bazuar në analizën periodike, UL ka ndërtuar një plan strategjik ku bie në sy si objektiv strategjik fuqizimi i partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me fokus mësimdhënien, kërkimin shkencor por dhe integrimin e studentëve në tregun e punës. <i>(Evidencat 23-Raporti vjetor FSHM 2022 – 2023, 17-Raporti vjetor UL 2021-2022 dhe 2022-2023, 13-Plani strategjik 2021 – 2025)</i>			
Konkluzione	UL e ka ndërtuar aktivitetin për hartimin, implementimin dhe monitorimin e programit të studimit Bachelor në "Infermieri" bazuar në një kuadër të plotë rregullator sipas kërkesave që burojnë nga Ligji i Arsimit të Lartë. Për realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe për plotësimin e shprehive praktike profesionale, institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione spitalore universitare publike, disa poliklinika dhe OSHKSH si dhe disa institucione private të kujdesit shëndetësor përmes të cilave siguron realizimin e praktikave klinike për studentët e këtij programi studimi me qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e infermieristikës aftë për të shërbyer në komunitet në parandalim, kurim edukim shëndetësor etj. Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione universitare dhe klinika mjekësore europiane që i shërbejnë jo vetëm aftësimin profesional të stafit dhe studentëve por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit.</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi Bachelor “Infermieri” është program i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. • Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriteve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. • Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë. • Kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademike/6 semestra. Çdo semestër ka 15 javë. • Vlerësimi në kredite: 180 ECTS (4500 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë). • 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit. • Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 10/15 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta. • Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB. <ul style="list-style-type: none"> ○ Viti I: 21 lëndë teorike + praktikë profesionale (semestri 2) ○ Viti II: 24 lëndë teorike + praktikë profesionale (semestri 1 dhe 2) ○ Viti III: 22 lëndë teorike + formim profesional(semestri 1 dhe 2) + Provimi i formimit/Tema e Diplomës <p>Referuar syllabuseve, lëndët janë organizuar në module bashkuar në tematikë (p.sh. pediatri dhe infermieristikë në pediatri grupohen në një modul).</p> <p>Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimi teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (labororë, praktikë profesionale). Referuar llogaritjeve në planin mësimor (<i>Evidenca 25</i>), orët totale janë 4500. Prova finale në planin mësimor ka 7 ECTS dhe 175 orë</p>



të organizuara në 75 orë në auditor (seminare) dhe 100 orë punë e pavarur.

Bsc "Infermieri "	Në total
Në auditor	
- Leksione	858
- Seminare	384
- Laboratore	191
- Praktika profesionale	510
- Projekte	20
Punë e pavarur e studentit	2537
Gjithsej	4500

GVJ konstaton se ka disa pasaktësi dhe mospërputhje në të dhënat e planit mësimor të plotësuar në tabelën 10 të RVB ku bie në sy veçanërisht lënda e vitit të parë Dietologji për të cilën nuk figuron asnjë orë mësimore, si dhe llogaritja e orëve totale të cilat janë 4807(viti 1 – 1363, viti 2 – 1843, viti 3 – 1600) kundrejt 4500(viti 1 – 1500, viti 2 – 1500, viti 3 – 1500) të paraqitura në evidencën 25 të cituar në tabelë.

- Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 50% për orët e leksioneve, 75% për orët e seminareve dhe 100% për orët e laboratorëve dhe praktikave.
- Viti akademik ka 3 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i vjeshtës-pas pushimeve verore. Rregullorja lejon dhe organizimin e sezoneve të posaçme të provimeve nga dekanatet me propozim të njësisë bazë dhe me miratim të rektoratit.
- Rregullorja e programit të studimit përcakton Provimin si formën kryesore të vlerësimit të nivelit të njohurive të fituara nga studenti gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik.
- Në kapitullin V të rregullores së programit të studimit evidentohet forma e vlerësimit përfundimtar me provim ose temë diplome.

(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor i programit të studimit, 14-Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara

Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në fushën e Infermierisë. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës.

Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" realizohet në 67 lëndë/module të cilat ofrojnë informacion teoriko-praktik të gjerë në fushën e infermierisë si dhe 5 në module praktike. Lëndët e formimit bazë mjekësor (Anatomi, Fiziologji, Biokimi dhe Biokimi klinike, Gjenetikë, Histologji, Mikrobiologji etj.) dhe formimit të përgjithshëm

<p>në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>(Sociologji, Psikologji, Gjuhë e Huaj, Informatikë, Legjislacion Shëndetësor etj.) janë pjesë e programit në vitin e parë të studimit. Në vitin e parë studenti merr njohuri dhe për infermieristikën e përgjithshme dhe puerikulturën.</p> <p>Në dy vitet e tjera, programi synon aftësimin teoriko-praktik të studentëve në fushat e gjera të aplikimit të kujdesit infermieror si kirurgji, pediatri, sëmundje infektive, sëmundje të brendshme, shëndet paliativ etj. Studenti merr informacion teoriko-praktik dhe për diagnozën radiologjike dhe imunologjike. Në vitin e fundit informacioni zgjerohet në fushën e geriatriisë si dhe merr njohuritë e para në ekonominë e shëndetit dhe menaxhimin shëndetësor.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në programin mësimor ze praktika profesionale (e shpërndarë në pesë semestra) e cila i krijon mundësi studentit të ballafaqojë njohuritë e marra në auditor me realitetin praktik diagnostik-terapeutik. Programi ka si mision të prezantojë studentët me aktivitete direkte në rastet e parandalimit, kurimit, rehabilitimit dhe procedurave të vlerësimeve funksionale.</p> <p>Programi në tërësi jep njohuri të përparuar në fushën e studimit dhe përgatit specialistë që konkurojnë denjësisht në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale.</p> <p>Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në fusha të ndryshme të kujdesit infermieror në sistemin e kujdesit primar apo spitalor. Formimi që jep programi i krijon mundësi studentit të kontribuojë në diagnozë, trajtim, rehabilitim, parandalim duke vendosur marrëdhënie besimi reciprok dhe bashkëpunuese me kolegët, eprorët dhe pacientët.</p> <p>Formimi i përgjithshëm dhe aftësimi profesional krijon premisa edhe për profilizim profesional në fusha më specifike si menaxhimi infermieror, kujdesi në geriatri, onkologjia si dhe thellimin e studimeve në Master Profesional apo Master Shkencor në “Infermieri”.</p> <p>Në diskutimin me studentët për situata klinike të caktuara dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, GVJ vlerësoi reagimin e studentëve për saktësinë dhe kompetencën.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor i programit të studimit, 14-Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB, takimi në Institucion me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar tabelës 9 të RVB dhe planit mësimor, GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë 36.5 ECTS ose 20.28% (standardi 15 – 20%) • Kategoria B: Lëndë karakterizuese 88.5 ECTS ose 49.17% (standardi 50 – 55%) • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 24 ECTS ose 13.3% (standardi 12 – 15%) • Kategoria D: Lëndë plotësuese 24 ECTS ose 13.3% (standardi 10 – 15%) • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 7 ECTS ose 3.9% (standardi 3 – 5%) <p>GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese ndonjëherë nuk përputhet me tipologjinë e lëndëve; p.sh. Infermieristika e përgjithshme, një lëndë profesionale formuese është kategorizuar si Lëndë Plotësuese (D).</p> <p>Planet mësimore rishikohen dhe aprovohen në fillim të çdo viti akademik nga senati akademik.</p> <p>(Evidencat 25-Plani mësimor i programit të studimit, 14-Syllabuset, 27/49-Praktika e miratimit të planit vjetor të punës për vitin akademik 2023 – 2024, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor konstatohet se praktika profesionale shpërndahet në mënyrë pothuaj proporcionale në të tre vitet e studimit duke nisur nga semestri i dytë i vitit të parë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë 13 ECTS • Në vitin e dytë 17.5 ECTS • Në vitin e tretë 13.5 ECTS <p>Në kreun V të rregullores së programit të studimit përcaktohen qartë kushtet e diplomimit, mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm si dhe mënyra e organizimit të mbrojtjes së temës së diplomës. Në planin mësimor përcaktohen 7 ECTS për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>(Evidencat 25-Plani mësimor i programit të studimit, 14-Syllabuset, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në UL pranimi dhe regjistrimi i studentëve në të gjitha programet e studimit bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe organizohet mbështetur në statutin dhe rregulloret e institucionit. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati.</p> <p>Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohet forma e organizimit të studimeve, kushtet dhe kriteret për t’u pranuar në programin e studimit, procedurat e pranimit dhe afatet e studimit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është program studimi i ciklit të parë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës</p>

	<p>Kombëtare të Kualifikimeve. Ai zhvillohet me kohë të plotë dhe në përputhje me gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” nuk i përket programeve me status të veçantë. UL aplikon sistem financimi për studentë të kategorive të veçanta dhe studentët e ekselencës mbështetur dhe në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe VKM 780, datë 26.12.2018.</p> <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 8-Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, 18-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”, 47-Praktika e plotë për FSHM, Vendim i Senatit akademik “Për miratimin e kuotavetë vitit akademik 2024-2025, 119-Rregullore për bursat studentore, 120-Statistika për bursat studentore 2021-2023)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Në RVB theksohet se programi i studimit Bachelor në “Infermieri” në UL ka një ngjashmëri në përmbajtje deri në masën 70% me programe të të njëjtës fushë. <i>Në dokumentacion nuk ka evidenca konkrete por në diskutim me stafin drejtues dhe GVB ekspertët u informuan se programi ka ngjashmëri në përmbajtje me programin me të njëjtën emërtesë të ofruar nga Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.</i> Në përgatitjen e programit të studimit institucioni ka patur në konsideratë dhe programe të ngjashme ndërkombëtare. Programi i studimit krijon mundësi për mobilitet në programe të ngjashme në fushën e infermierisë. Programi i studimit i jep studentëve një përgatitje të qëndrueshme për të ndjekur dhe ciklin e dytë të studimeve në këtë fushë.</p> <p>Në takimin me drejtuesit e institucionit GVJ u informua se programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është një program i ri dhe po punohet për të siguruar qëndrueshmëri dhe përshtatje me programe të ngjashme të Unionit Europian. Institucioni ka një bashkëpunim dhe ka marrë ekspertizë nga Emory University (Atlanta, USA) dhe po punon për krijimin e një programi në anglisht duke synuar ndërkombëtarizimin e programit.</p> <p><i>(RVB, Takimi me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë të programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në RVB deklarohet se Programi i studimit është kodifikuar sipas fushës së studimit nga MASR. Për këtë program studimi është kryer dhe kodifikimi i lëndëve pasqyruar në syllabuset përkatëse. Kodifikimet janë përcjellë nga UL me shkresën Nr. 76, datë 29.03.2023.</p> <p>Programi i studimit wshtw i kodifikuar sipas legjislacionit nw fuqi dhe mban kodin 63BA0913S.</p> <p><i>(Evidenca 14-Syllabuset e lëndëve, RVB)</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet. Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët.</p>

institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.									
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të UL bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati.</i></p> <p><i>Institucioni deklaron se Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë. GVJ konstaton mospërputhje të orëve dhe të lëndëve në planin mësimor dhe tabelën 9 të RVB dhe rekomandon rishikimin e shpërndarjes së tyre sipas veprimtarive dhe në përshtatje të plotë me tipologjinë e lëndës.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>UL është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë.</p> <p>Institucioni përbëhet nga organet akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademike (rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë); organe administrative që janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësive kryesore; organe kolegjiale që janë rektorati, dekanati, këshilli etikës.</p> <p>UL ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.115, datë 15.12.2017, për një periudhë 6 vjeçare. UL është në proces të riakreditimit institucional.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafu», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UL që ofron programin e studimit Bachelor në “Infermieri” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. FSHM përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Infermieri” ka tre departamente:

1. Departamenti i Stomatologjisë
2. Departamenti i Farmacisë
3. Departamenti i Infermierisë

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Infermierisë.

Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2023 – 2024, njësia bazë përbëhet nga **11 anëtarë PAE** dhe përfshin në mësimdhënie dhe **19 anëtarë PAK**. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

PAE	PAK
Tituj/Grada	Tituj/Grada
(1) Prof.	(3) Prof.
(2) Prof. Asc.	(2) Prof. Asc.
(3) Dr.	(9) Dr.
(1) Dr në proçes	(5) Msc.
(4) Msc.	

Lidhur me treguesit e moshës, pjesa më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë dhe gradë shkencore doktor i përkasin grup moshës 36-65 vjeç. Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik rezultojnë se stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi ka një ndërthurje të profesorëve me përvojë të gjatë akademike (të angazhuar si PAE apo PAK) dhe pedagogëve të rinj.

Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezultojnë se llogaritur me orët totale, PAE mbulojnë 55.4% të dhe PAK 44.6%. **GVJ konstaton se nuk përmbushet kriteri ligjor sipas të cilit 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohet nga PAE.**

(Evidencat 1-Statuti i UL, 18-rregullore e Departamentit të Infermierisë, 34-CV e personelit akademik, 36-Të dhëna statistikore të personelit akademik, Tabelat 2, 4, 6, 8 të RVB)

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

FSHM dhe Departamenti i Infermierisë kanë angazhuar në këtë program studimi dhe staf ndihmës akademik të përbërë nga tre laborante dhe një sekretare që asistojnë studentët në realizimin e punëve laboratorike dhe praktikave në mjediset e institucionit dhe asistojnë studentët për problematika të proçesit mësimor. Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrativ i institucionit. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës akademik dhe administrativ dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.

(Tabelat 1 dhe 2 të RVB, takimet në institucion)

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është i vetmi program studimi që ofron Departamenti i Infermierisë pranë FSHM në Universitetin Luarasi. Për ofrimin dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit, Departamenti i Infermierisë bashkëpunon me dy departamentet e tjera të FSHM, departamentin e Farmacisë dhe Departamentin e Stomatologjisë. Përgjegjësi i departamentit është dhe koordinatori i programit të studimit. Ai përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale. Përgjegjësi i departamentit informon në mënyrë periodike dekanin e FSHM për mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe informon departamentin në mbledhjet periodike për ecurinë, problematikat si dhe diskuton masat për zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 18-Rregullore e Departamentit të Infermierisë, 37-Mbledhje e Departamentit të Infermierisë)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UL, FSHM dhe Departamenti i Infermierisë që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Infermieri” përmbushin kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Stafit akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me ndërthurje moshore, me grada e tituj ose në proces për marrjen e tyre. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik dhe personelin administrativ. Në përmbushje të kërkesave ligjore përgjegjësi i departamentit është dhe koordinatori përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash siguron lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Infermierisë në UL që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Infermieri” disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacionet menaxhohen përmes një sistemi intranet të brendshëm në të cilën ka akses i gjithë personeli.</p> <p>Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimi, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin i diplomës.</p> <p>Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Syllabuset hidhe dhe në aplikacionin Teams/Moodle për të mundësuar aksesin e shpejtë. Të dhëna të detajuara të programit të studimit gjenden dhe në faqen eëvb të UL.</p> <p>Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit.</p> <p>(Dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është i organizuar në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore).</p> <p>Për secilën lëndë jepet informacion i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika.</p> <p>GVJ gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës.</p> <p>(Evidenca 25-Plani mësimor i programit të studimit, Tabelat 9 dhe 10 të RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Procedurat e pranimi të studentëve në programin e studimit Bachelor në “Infermieri” bazohen në rregulloren e UL të FSHM dhe në rregulloren e programit të studimit. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimi që vendosen me VKM dhe rregulloren e UL.</p> <p>FSHM propozon kriteret dhe kuotat e pranimi, kuotat e transferimit etj. mbështetur në kapacitetet pritëse dhe akademike të cilat miratohen nga senati akademik dhe dërgohen në QSHA. Informacioni publikohet në faqen zyrtare on line të UL dhe në portalin U-Albania. Proçesi i pranimi menaxhohet nga QSHA dhe RASH. Institucioni nxjerr njoftime për pranimin ku përshkruhet proçedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informacioni gjendet dhe në website të UL.</p> <p>Institucioni ka parashikuar dhe proçedurën e regjistrimit në këtë program studimi si program i dytë .</p> <p>Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe</p>

	<p>të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>(Evidencat 1-Statuti i UL, 11-Rregullore e programit të studimit, 46/47-Praktika e plotë e FSHM për propozimin e kriterëve dhe miratimin e kuotave për pranimin e studentëve, Faqja Ëeb, Takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë dhe për praktikën profesionale. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës.</p> <p><i>Bien në sy fakti që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Disa nga titullarët janë me gradë Dr. ndërkohe që ka dhe titullarë me Msc. GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore.</i></p> <p>Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar.</p> <p><i>GVJ konstatoi se literaturë e detyruar në syllabuse janë leksionet e shtypura të pedagogëve. Literatura e rekomanduar në shumicën e syllabuseve është e para 5 – 10 viteve. GVJ rekomandon rifreskimin e literaturës dhe shtimin e librave në literaturën e detyruar.</i></p> <p><i>(Evidencat 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se programet e studimit në UL janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi Bachelor në “Infermieri” është organizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse. Propozimet për përmirësim (brenda kufirit 20% të përcaktuar në kuadrin ligjor) janë pasqyruar dhe në planin vjetor të punës. Theksojmë se ndryshime më të thella mund të bëhen vetëm pas marrjes së akreditimit të parë. Rishikimi dhe përditësimi i programit të studimit bëhet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe NJSBC dhe aprovohen nga Senati Akademik.</p>

	<i>(Evidenca 17-Raporti vjetor UL, 50-Vendim i senatit akademik për manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, takimi me drejtuesit në institucion)</i>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë) por janë Dr. ose Msc.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se nuk përmbushet kriteri ligjor sipas të cilit 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohet nga PAE.</i></p> <p><i>Literatura e përdorur është më e vjetër se 5 viteve të fundit.</i></p> <p><i>Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale. Numri i lartë i orëve të praktikave profesionale (64 ECTS) i bën studentët të aftë për manipulim dhe punë të pavarur në fushën e infermierisë.</p> <p>Veçori e këtij programi është përgatitja e gjerë në infermieri që i krijon mundësi punësimi dhe kualifikimi të mëtejshëm studentëve në nënspecialitetet e shërbimit infermieror por dhe në fushat e menaxhimit apo të kujdesit geriatrik dhe kujdesit në shtëpi, fusha për të cilat tregu ka mjaft nevojë në kushtet e shtimit të jetëgjatësisë dhe moshimit të popullatës. <i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve)</i></p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe	<p>Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p>Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave</p>

<p>rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme.</p> <p>Pëmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor në “Infermieri”. Studentët marrin një formim të gjerë për kujdesin infermior në shumë specialitete si kirurgji, sëmundje të brendshme, pediatri, psikiatri, onkologji, sëmundje infektive, ORL etj. Programi i përgatit studentët me elementë të etikës, sociologjisë dhe psikologjisë për të kultivuar tek specialistët e ardhshëm nocionet e komunikimit me pacientin. Njohuritë në informatikë, biostatistikë etj. i përgatisin studentët për një treg pune që përdor çdo ditë e më shumë elementë të inteligjencës artificiale si dhe ofron një bazë të mirë për studentët që duan të thellojnë njohuritë në nivelin Master Shkencor apo duan të përfshihen në realizimin e projekteve shkencore.</p> <p>Hapësira dedikuar praktikës në program dhe shtrirja e saj në vite e semestra mundëson arritjen e objektivave për formimin e shprehive praktike në manipulim me pacientin.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit është strukturuar bazuar në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë.</p> <p>Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. Projektet e mobilitetit (Erasmus) si dhe bashkëpunimet me institucione ndërkombëtare në të cilat janë përfshirë staf akademik i Departamentit të Infermierisë dhe studentë, shërbejnë si një impuls i mirë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të programit.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve, 22-Marrëveshje bashkëpunimi me Michels Kliniken GmbH&CoKG)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkures në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Në takimet me studentët dhe Zyrën e këshillimit të karrierës u informuam se pjesa më e madhe e studentëve që mbarojnë këtë program studimi synojnë të ndjekin studimet në nivelin e dytë Master në “Infermieri”. Tregu lokal i punës tërheq një pjesë të studentëve. Zyra e këshillimit të karrierës luan një rol aktiv pasi koordinon dërgimin e informacionit tek studentët dhe i ndihmon këta të fundit në aplikimet e tyre duke i paisur dhe me rekomandime. Në takime u informuam se ka patur kërkesa për punësim të studentëve të këtij programi si ndihmesinfermierë në klinika private dhe nga institucionet e praktikave. Funksonon marrëveshja me me klinikën “Michels Kliniken GmbH&CoKG” në Gjermani për të dërguar studentë për intership dhe më tej ndoshta për punësim.</p>

	<p>Punësimi i studentëve të këtij programi studimi është gjithsesi me kohë të pjesshme pasi brezi i parë i studentëve sapo është diplomuar.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 22-Marrëveshje bashkëpunimi me Michels Kliniken GmbH&CoKG, Takimet me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni dhe Studentët)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Kërkesa e Drejtuesit të Departamentit për rishikimin e syllabuseve nga titullarët e lëndëve është e përvitshme. Proçesi i përditësimit të syllabuseve, përfshi dhe literaturën bazë dhe të rekomanduar monitorohet nga përgjegjësi i departamentit, Zyra e zhvillimit të kurrikulave dhe NJSBC. Në syllabuse është punuar për përditësimin e literaturës së huaj e ndihmuar dhe nga rikonceptimi i funksionimit të bibliotekës.</p> <p>Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi pregatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët. Në syllabuse, leksionet e shkruara të pedagogëve janë literaturë e detyruar. <i>GVJ rekomandon që veç leksioneve të pedagogëve, literatura bazë duhet të përfshijë edhe tekste mësimore si dhe inkurajon përditësimin e fondit të literaturës në bibliotekë me tituj të 5 viteve të fundit për të tëra lëndët e programit të studimit.</i></p> <p><i>(Evidencat 14-Syllabuset e lëndëve, 27-Praktika e miratimit të planeve dhe programeve mësimore 2023-2024, takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi është konceptuar dhe organizuar me njohuri teorike që rrjedhin nga shkencat bazë të mjekësisë të cilat trajtohen në aspektin aplikativ duke krijuar një bazë formuese për të vlerësuar me një sy klinik situatat e paraqitura.</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit, objektivi kryesor është t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e infermierisë. Në funksion të këtij objektivi programi synin dhënien e një tërësie njohurish teorike dhe aplikative në fushën e infermieristikës për të përgatitur specialistë të aftë për tregun e punës si dhe për të garantuar vijimin e studimeve të mëtejshme në fushën e infermierisë. Programi është i gjerë dhe pais studentin me njohuri specifike për shërbimin infermieror në Sëmundje të brendshme, Kirurgji, Pediatri, Obstetrikë-Gjinekologji, Onkologji, Radiologji-Fizioterapi etj. Programi i studimit synon jo vetëm formimin profesional por dhe edukimin e vlerave etike dhe njerëzore të domosdoshme për të realizuar misionin e profesionit të infermierit.</p> <p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit garanton përmbushjen e këtyre objektivave dhe përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Bachelor në "Infermieri". Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet.</p>



	<i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve)</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është strukturuar në përputhje me kërkesat e ligjore. Programi i pajis studentët me një bazë të mirë njohurish teoriko-praktike të formimit të përgjithshëm infermieror dhe njohuri specifike të shërbimit infermieror në specialitete. Përmes formimit të gjithanshëm programi synon të krijojë mundësi për punësimin e studentëve sipas kërkesave të tregut të punës. UL demonstron komunikim të ngushtë me institucionet e kryerjes së praktikës profesionale edhe për punësimin e studentëve të fushë së infermierisë. UL inkurajon studentët e këtij programi studimi për përfshirje në veprimtari kërkimore-shkencore me mbështetjen dhe bashkëpunimin e pedagogëve si dhe organizon konferenca vjetore në të cilat studentët kanë mundësi të referojnë punime të tyre. <i>Megjithatë, referuar tëbelës 22 të RVB dhe informacionit të marrë në takimet në institucion rezulton se studentët e këtij programi studimi nuk janë angazhuar në projekte të tilla.</i> <i>(Evidencat 11-Rregullore e programit të studimit, 25-Plani mësimor, 14-Syllabuset e lëndëve, 24-Konferenca e FSHM Mars 2022, tabela 22 e RVB)</i>			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe	Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" është ndërtuar në përputhje me vizionin dhe misionin e UL si dhe fushën e studimit të FSHM dhe Departamentit të Infermierisë. Ai është një program i ri në një institucion me përvojë akademike i ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore, kërkesat e tregut të punës dhe strategjitë kombëtare

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të shëndetësisë. Vizioni i zhvillimit përshkruhet qartë në dokumentat strategjike që na u vunë në dispozicion.</p> <p>Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik GVJ u informua se përmes analizave dhe debatit shkencor në nivel Departamenti dhe Fakulteti diskutohen dhe aplikohen ndryshimet përmirësuese të programeve me kontributin e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie dhe profesorëve të ftuar. Eksperienca dhe kompetenca profesionale e stafit me përvojë si dhe mundësitë për mobilitet dhe pjesëmarrje në projekte për pedagogët e rinj ka bërë që stafi akademik të njihet dhe të aplikojë më mirë programe bashkëkohore që përshtasin programet aktuale me kërkesat e tregut të punës dhe me kërkesat e kartës së Bolonjës.</p> <p>GVJ u informua se institucioni ka krijuar lidhje të qëndrueshme me aktorët e tregut të punës dhe institucionet partnere që ofrojnë programe të ngjashme studimi. Në takimin me drejtuesit e institucionit GVJ u informua se programi i studimit Bachelor në “Infermieri” është një program i ri dhe po punohet për të siguruar qëndrueshmëri dhe përshtatje me programe të ngjashme të Unionit Europian. Institucioni ka një bashkëpunim dhe ka marrë ekspertizë nga Emory University (Atlanta, USA) dhe po punon për krijimin e një programi në anglisht duke synuar ndërkombëtarizimin e programit.</p> <p><i>(Evidencat 11-Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në “Infermieri”, 13-Plani strategjik i zhvillimit të UL 2021 – 2025, 21-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale, takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në parim UL nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor.</p> <p>Nuk ka ende studentë të diplomuar në këtë program studimi, pritet të diplomohet brezi i parë i studentëve.</p> <p>Departamenti i infermierisë mban kontakte të vazhdueshme me studentët dhe tërheq mendimet dhe sugjerimet e tyre për programin dhe realizimin e tij. Instrumenti kryesor në funksion të përmirësimit të programit të studimit është pyetsori studentor por inkurajohen dhe diskutimet me pedagogët për tërheqjen e vlerësimit dhe sugjerimeve të studentëve për përfitimet e tyre në lëndët teorike dhe në seancat praktike.</p> <p>Studentët kanë organizimin e tyre në këshilla studentorë si dhe përfaqësues në senatin akademik dhe NJSBC. Përmes përfaqësuesve studentët kanë mundësi të përçojnë direkt sugjerimet për përmirësim të programit si dhe problematikat lidhur me të.</p> <p><i>(Evidencat 57-Formular vlerësimi nga studentët për pedagogun e lëndës, 59-Proçesverbal i këshillit studentor, RVB, takimet në institucion)</i></p>

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierëve të Shqipërisë, me institucione spitalore dhe të shërbimit primar, publike dhe private si dhe institucione homologe jashtë Shqipërisë. Rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit. (Evidenca 21-Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për kryerjen e praktikave mësimore dhe profesionale)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e kohës. Studentët kanë aftësitë e duhura për të ndjekur studimet master apo për tu punësuar. Në parim UL nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor. Gjithashtu, rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi i studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale e klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome etj. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe ëorkshop. Aktivitetet trajnuese klinike janë pjesë integrale e programeve të lëndëve infermieristike. UL trajnon në mënyrë të vazhdueshme stafin për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+3.55 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Programi i studimit Bachelor në “Infermieri” përfshin orë teorike dhe orë praktike (në laborator apo në institucionet e kryerjes së praktikës profesionale), detyra kursi, pregatitje të diplomës etj. të paraqitura në tabelën e mëposhtme të shpërndara sipas tipologjive të mësimdhënies. Në tabelë nuk figuron tema e diplomës pasi puna në auditor për pregatitjen e saj është përfshirë në rubrikën e seminareve.

Bsc “Infermieri”	Viti I	Viti II	Viti III	Në total
Në auditor				1963 (43.6%)
- Leksione	321	280	257	858
- Seminare	129	105	150	384
- Laboratore	101	45	45	191
- Projekt	6	7	7	20
- Praktika profesionale	120	210	180	510
Punë e pavarur e studentit				2537 (56.4%)
Gjithsej				4500

(Evidencat 25-Plani Mësimor, 14-Syllabusete lëndëve, Tabelat e RVB)

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.

Në takimet në institucion me personelin akademik dhe me studentët GVJ u informua se personeli akademik ka përvijë dhe ofron për studentët mënyra e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me nevojat e tyre. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda të tilla si prezantime në ppt., video, biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike me mulazhe, ushtrime me raste klinike etj. Stafin akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin teorik, laboratorëve mësimore apo praktikave profesionale ku synohet pjesëmarrje aktive në procedura praktike infermierore. Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; stimulohet mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të.

Institucioni ka krijuar infrastrukturën e domosdoshme për aplikimin e metodave inovative në mësimdhënie dhe ka trajnuar stafin për përdorimin e tyre. Biblioteka on line lehtëson përdorimin e literaturës duke mundësuar shfrytëzimin e saj nga studenti edhe në distance.

(Evidencat 48-Udhëzues metodat inovative të mësimdhënies, 62-Infrastruktura IT viti akademik 2023-2024, 63/64-Biblioteka on line, Takimet dhe vizitat në institucion)

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik

Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore të përgjithshme e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të

<p>në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. <i>GVJ konstaton se mungon laborator i dedikuar i infermieristikës i domosdoshëm për realizimin e plotë të praktikave infermieristike me mulazhe. GVJ u informua se në mungesë të tij, pedagogët përdorin simulimet e prezantuara me video si dhe aplikimet praktike pranë qendrave të realizimit të praktikave profesionale.</i></p> <p>Institucioni kujdeset për trajnimin periodik të stafit për metodat e reja të mësimdhënies si dhe monitoron realizimin e procesit mësimor. Vizitat në kuadër të marrëveshjes Erasmus+ janë një mundësi e mirë për trajnim dhe shkëmbim eksperience nga pedagogët. Institucioni inkurajon dhe mbështet pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca, përfshirjen e tyre në studime dhe publikime si dhe angazhimin në projekte nacionale dhe ndërkombëtare. Janë 19 botime dhe 2 aktivitete të realizuara nga Departamenti i Infermierisë dhe FSHM. Në takimin me stafin GVJ u informua se po punohet për përgatitjen e aplikimit pranë AKKSHI për dy projekte. FSHM planifikon gjithashtu të hapë një klinikë mjekësore për të ofruar kujdes shëndetësor për individë me ekonomi të kufizuar.</p> <p><i>(Evidencat 12-Strategjia e kërkimit shkencor, 65-Modul trajnimi akademik, 66- Strategjia e ndërkombëtarizimit, 68-Marrëveshje Erasmus+, tabelat 16/19/20 të RVB, vizita dhe takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizë dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional. P.sh. praktikat profesionale infermiore zhvillohen nga mjekë, ka lëndë si anestezi-reanimacioni, biostatistika, radiologji-fizioterapi, infermieri në ortopedi-traumatologji etj. që jepen nga pedagogë që nuk janë të profilit.</i> • <i>Lëndët e infermierisë mbulojnë kryesisht nga mjekë.</i> • <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë. Megjithatë ngarkesa mësimore e tyre nuk është mbi normën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi, diversiteti i tematikave jashtë profilit të diplomimit ul cilësinë e mësimdhënies. P.sh. një pedagog, Msc. me ekspertizë në logopedi jep biostatistikë, anestezi-reanimacion, Infermieri në neurologji, Infermieri në psikiatri dhe pedagogji.</i> • <i>Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën “Doktorë Shkence”.</i>

- **GVJ konstaton se CV e personelit akademik nuk janë të plota. Në dokumentacion mungojnë disa CV të pedagogëve të përfshirë aktualisht në këtë program studimi dhe janë disa CV të pedagogëve që nuk janë personel akademik në këtë program.**

GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.

Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për tre vite akademike paraqitet si më poshtë:

Tituj/ grada	2023-2024		2022-2023		2021-2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	3	2	4	1	4
Prof.Asc.	2	2	3	1	2	2
Dr./PhD.	3+1*	9	4+1*	7+1*	2+1*	9
Msc.	4	5	0	17	2	8
Totali	11	19	10	30	8	23

*** Doktoraturë në proces**

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se ka qëndrueshmëri të strukturës së titujve dhe gradave për PAE në këto 3 vite si dhe shtim të numrit të PAK me doktoraturë. Lidhur me treguesit e moshës konstatohet se pedagogët e kategorisë Profesor janë me moshë mbi 56 vjeç. Lektorët me gradën Doktor i përkasin grupmoshës 36 – 65 vjeç. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në orët e mësimi si dhe me materialet didaktike që pedagogët përgatisin për procesin mësimor. Studentët ndihen të mbështetur dhe konstatohet një frymë pozitive hierarkie dhe bashkëpunimi.

(Evidencat Tabelat e RVB, 34-CV e personelit akademik, takimet dhe vizita në institucion)

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.

Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit, takimet e studentëve me dekanin, zëvendësrektorët dhe NJSBC. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjykojnë tërheqës procesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit. Në takimin me studentët ata u shprehën se shpjegimi është i qartë dhe reflekton përdorimin e metodave inovative. Në orën e mësimi ka

	<p>bashkëveprim interaktiv pedagog-student. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student. Vlerësimi i pedagogëve përfshin dhe instrumenta të tjerë si vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjatë zhvillimit të procesit mësimor dhe vlerësimi i performancës vjetore.</p> <p><i>(Evidencat 2-Rregullore e brendshme e UL, 71-Raport mbi vëzhgimin e paralajmëruar të stafit akademik, 59-formular vlerësimi nga studentit për pedagogun dhe lëndën, 72-Formular vlerësimi i performancës vjetore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të pedagogut)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka organizuar NJSBC e cila koordinon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni përmes strukturave organizative të tij mbështet trajnimin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte zhvillimi në të cilat veç aftësisht shkencor fitohet dhe eksperiencë në mësimdhënie. Për promovimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve institucioni organizon aktivitete e konferenca me bashkëpunimin e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë.</p> <p>Personeli është trajnuar dhe mbështetet vazhdimisht për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies.</p> <p>Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit. NJSBC ka krijuar protokollat për përgatitjen e pyetsorëve në nivel institucional.</p> <p>Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma pozitive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë.</p> <p><i>(Evidencat 73-Raportet vjetore të NJSBC, 74-Raporti i monitorimit të procesit mësimor në bazë semistri/viti akademik, 48-Metodat inovative të mësimdhënies, 37-Shembull Mbledhje departamenti të infermierisë, takimet në institucion)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgjithësisht përgatitje profesionale, ekspertizën dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.</i></p> <p><i>Megjithatë GVJ konstatoi se ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional, një pedagog jep më shumë se tre lëndë. Ka Lektorë pedagoge të kategorisë Msc, ku legjislati përcakton që lektorët duhet të jenë të zotërojnë gradën "Doktorë Shkence".</i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksibile të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit</i></p>

	<i>profesional teorik të studentëve. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive. <i>(Evidencat 2-Rregullore e brendshme e UL, 9-Rregullore e FSHM, 11, Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen në javën e parë të vitit akademik mbi kuadrin rregullator të programit mësimor. Ato informohen në orët e para të mësimit nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloret e funksionimit të Fakultetit, dhe programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Komponentë të vlerësimit janë pjesëmarrja aktive në seminare, detyrat e kursit, testimi i ndërmjetëm dhe testimi përfundimtar. Të dhënat për mënyrën e vlerësimit janë pasqyruar në tabelën 15 të RVB. Në kreun IV të rregullores së programit të studimit përcaktohen qartë: <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i vlerësimit për lëndë e module • Sezonet e provimeve • Organizimi i provimit • Kushtet për të hyrë në provim • Mënyra e zhvillimit të provimeve • Mënyra e vlerësimit dhe kushtet kur studenti konsiderohet i kalues/i mbetur • Dokumentimi i rezultateve • Proçedurat e ankimimit, riprovimeve, përmirësimit <i>(Evidenca 11- Rregullorja e programit të studimit, Takimi me studentët)</i>

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Në takimin me stafin akademik u informuam se provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe firmoset nga drejtuesi i njësisë bazë para zhvillimit të provimit.</p> <p>Kohëzgjatja e provimit përcaktohet në rregulloren e programeve të studimit nga njësia bazë. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 10 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer.</p> <p>Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së programit të studimit/regullorja e departamentit.</p> <p><i>(Rregullore e programit të studimit, paketa e syllabuseve, RVB, takimi me stafin)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe studentët u informuam se përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i Departamentit të Infermierisë ku zhvillohet ky program studimi. Për këtë qëllim çdo vit departamenti mbledh kërkesat lidhur me metodat e mësimdhënies, i diskuton në departament dhe përcakton buxhetin e nevojshëm i cili i paraqitet strukturave drejtuese të FSHM. Gjatë diskutimit me stafin dhe drejtuesit e institucionit u theksua se një vend të rëndësishëm në përgatitjen e buxhetit zënë dhe propozimet e bëra nga studentët, këshilli studentor si dhe rezultatet e pyetsorit të studentëve ku studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre për stafin akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik (Nuk ka dokumentime shpresore të këtij procesi).</p> <p>Institucioni ka mbështetur me materiale trajnuese përdorimin e platformave online.</p> <p><i>(Takimet me stafin drejtues, stafin akademik dhe studentët, Evidencat 32,33 – udhëzuesit për përdorimin e platformës Pitagora)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e</p>	<p>Institucioni ofron mundësi për përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike duke patur në qendër studentin.</p> <p>Studentët inkurajohen për punë të pavarur në ambientet e laboratorëve dhe në institucionet e kryerjes së praktikës për të krijuar sensin e autonomisë dhe forcuar besimin në aftësitë dhe gjykimin profesional. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në zgjedhjen e temës ashtu dhe në hartimin e saj. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student.</p>

<p>mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në UL funksionon sistemi i tutoratit qëndihmon studentin në orientim dhe në zgjidhjen e problemeve që lidhen me procesin mësimor. Mardhëniet e ndërsjellta pedagog-student apo pedagog-pedagog ndërtohen bazuar në kodin e Etikës. (Evidencat 76-Rregullore e tutoriatit, Kodi i etikës, takimet në institucion)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i Departamentit të Infermieristikës ku zhvillohet ky program studimi. Departamenti përfshin dhe studentët në këtë proces. Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe syllabuse përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 20% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive dhe projektet • 20% e pikëve të notës fitohen nga provimi i ndërmjetëm • 60 – % e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>(Evidenca 11- Rregullorja e programit të studimit, 34- syllabuset)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i studentëve është bazuar në korigjimin e provimit me shkrim ose komunikimit të vlerësimit të përgjigjes me gojë në formë pikësh. Vetëm pasi mbledhen pikët, rezultati konfirmohet. Në disa raste është tentuar vlerësim elektronik me Office 365. Parashikohet që së shpejti do të vihet në funksionim sistemi Clean score. <i>(Evidenca 11- Rregullorja e programit të studimit, 34- syllabuset)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar nga një komisioni i përbërë nga dy pedagogë. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Sekretaria mësimore nxjerr frekuentimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave të studentit si dhe konfirmon realizimin e pagesave që ka detyrim studentit përpara se ai të hyjë në provim. Proçesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit. GVJ u njoh në sekretarinë mësimore me formatin e fletës së provimit dhe proçedurën. <i>(Evidencat 2-Rregullore e brendshme e UL, 9-Rregullore e FSHM, 11, Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e proçesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e proçesit mësimor por dhe me numrin e ECTSve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studentin duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e arritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit. <i>(Evidencat 2-Rregullore e brendshme e UL, 9-Rregullore e FSHM, 11, Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UL ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloret e institucionit dhe në kodin e etikës pasqyrohen penaltete për rastet e kopjimit apo plagjiaturës. Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse

	<p>konstatohet kopjim në provim apo detyra kursi studenti i jepet vërejtje dhe i zerohet rezultati i provimit. Kontrolli për plagjiaturë është i parashikuar dhe në mbrojtjen e diplomës.</p> <p><i>(Evidencat 11- Rregullore e programit të studimit, 78-Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 2 javëve pas zhvillimit të provimit. Zakonisht korrigjimi bëhet brenda 10 ditësh. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Notat jepen në mënyrë konfidenciale gojarisht ose studentët logohen në platforme Pitagora. Nëse provimi realizohet me gojë rezultati merret menjëherë pas provimit.</p> <p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve.</p> <p><i>(Evidencat 11- Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit.</p> <p>Nëse studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe sqarimin nga pedagogu, i paraqet ankesë me shkrim drejtuesit të departamentit i cili bën verifikimet e duhura dhe nëse nuk e zgjidh ankesën vë në dijeni dekanin. Dekani ngre komision pa prani të pedagogëve të korrigjimit të parë për verifikimim e ankesës së studentit dhe bën verësimin e provimit.</p> <p>Nëse provimi është zhvilluar me gojë studenti përsërit provimin në prani të komisionit duke tërhequr një tezë të dytë. Vlerësimi në këtë provim mbetet vlerësimi përfundimtar i studentit. Proçesi i ankimit kryhet në përputhje me rregulloren e provimit dhe rregulloren e programit të studimit. Ndryshimi i rezultatit të provimit pasqyrohet në proçesverbali e firmosur nga komisioni dhe i bashkangjitet vlerësimit të komisionit të mëparshëm dhe sistemin EMS.</p> <p>E gjithë proçedura e ankesës dhe rivlerësimi të studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>(Evidencat 77-Rregullore provimeve, 11- Rregullore e Programit të Studimit, Takimi me stafin akademik)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçesin e ankimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mbarëvajtja e provimit është</i></p>

	<p>përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin EMS. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. UL ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Infermierisë. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Volumi që zënë orët e praktikës mësimore dhe profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohenn gjatë manipulimeve në manekinë apo paisje mjekësore që janë në dispozicion në studentevë në laboratorët e FSHM.</p> <p><i>(Evidencat Plani mësimor, Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, biofizikë, ekonomi dhe menaxhim shëndetësor, etikë. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. FSHM ka një laborator të kompletuar të informatikës në funksion të përgatitjes së studentëve.</p> <p><i>(Evidencat 11-Plani mësimor i programit të studimit, 34-Syllabuse,t vizita e ambienteve në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre</p>	<p>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët.</p> <p><i>(Evidencat 11-Plani mësimor i programit të studimit, Takimi me studentët dhe stafin akademik)</i></p>

dhe për detyrimet përmbyllëse.	
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Programi Bachelor në "Infermieri" ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit/legjislacionit për pranimin e përgjegjësive apo vendimeve individuale lidhur me gabime të mundëshme në praktikë, raportimin dhe marrjen e masave korigjuese. Studentët marrin njohuri edhe për fusha specifike të kujdesit infermieror.</p> <p>Programi i studimit është specifik dhe bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimi në auditor. Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale.</p> <p>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët inkurajohen të përfshihen në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme. Megjithatë, nuk ka ende pjesmarrje të tyre në këto aktivitete.</p> <p><i>(Evidencat 25 – Plani mësimor, 28 – Dosje e praktikës profesionale, 65 – Modul trajnimi Academic writing skills, Takimi me studentët dhe stafin akademik)</i></p>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, departamenti i infermieristikës në bashkëpunim me departamentet e tjera të FSHM si dhe mjekë nga institucione shëndetësorë apo institucione arsimore vëndase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, tavolina të rrumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve.</p> <p>Institucioni mbështet publikimet e pedagogëve. Aktivitetet e hapura, leksinet dhe ëorkshop-et ndihmojnë në bashkëveprimin interaktiv me kolegë shqiptarë dhe të huaj në funksion të diagnozës.</p> <p><i>(Eviencat 79-Lista e aktiviteteve të hapura dhe promovimit të librave, 17U-Raporti vjetor, 80-Rregullore e kërkimit shkencor, 81- Leksione të hapura)</i></p>
Konkluzione	<i>Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Infermierisë. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi,</i>

	<p><i>prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe formim bazë dhe të avancuar infermieror. Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë, terminologji mjekësore, ekonomi menaxhimi, etikë. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesëmarrjen e mjekëve të shquar vendas apo të huaj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentit në fund të studimeve i lind e drejta të pajiset me diplomë Bachelor në “Infermieri” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur diplomë ose provimin final. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e FSHM, Departamentit të Infermierisë dhe të programit të studimit në të cilat përshkruhet qartë proçedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome. Ky informacion bëhet publik për studentët. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës dhe formatit të saj. <i>(Evidencat 78-Udhëzues për punimin e Diplomës, 31- Rregullore e diplomimit, 81- Vendim i njësisë bzë për notën mesatare)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Fokusi i programit Bachelor në “Infermieri” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në provimin përfundimtarë ose në përgatitjen e një teme diplome. Pedagogët i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzohen në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet</p>

	<p>shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantim e materialit. Programi i provimit i hartuar nga stafi i njësisë bazë dhe i miratuar nga Dekani afishohet.</p> <p><i>(Evidencat 78-Udhëzues për punimin e Diplomës,83-Proçesverbal për informimit për provimin e fundit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Teza e provimit përmban pyetje shtjelluese dhe kuize.</p> <p>Komisioni i ngritur nga departamenti përgatit tezën përfundimtare bazuar në temat e paraqitura nga secili pedagog. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. Rezultatet e provimit të përgjithshëm përfundimtar u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i provimit të formimit pasqyrohen në proçesverbalin përkatës dhe Sistemin e menaxhimit të të dhënave. Korrigjimi i provimit përfundimtar kryhet nga një komision vlerësimi i miratuar nga dekani i fakultetit. Proçesverbali përfundimtar i rezultatit të provimeve firmoset nga komisioni i vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari.</p> <p><i>(Evidencat 31-Rregullore e diplomimit, 84-Ngritja e komisionit për provimin e përgjithshëm përfundimtar, 85-Urdher për aprovimin e temave të diplomave)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> <p>Përpara përfundimit të studimeve departamenti përcakton lëndët e formimit të përgjithshëm, karakterizues dhe me zgjedhje që do përfshihen në provim dhe titullari i lëndës përcakton temat që do përfshihen në provim të cilat do përbëjnë fondin e pyetjeve të provimit. Këto ju vihen në dispozicion studentëve në ẽbsite e Universitetit dhe afishohen në ambientet e departamentit. Studenti informohet për fondin e pyetjeve dhe mënyrën e vlerësimit dy muaj përpara përfundimit të semestrit.</p> <p>Temat e diplomës dhe pedagogët udhëheqës të cilat pasi miratohen në departament ju vihen në dispozicion studentëve. Studentët asistohen nga pedagogët udhëheqës së temës së diplomës gjatë hartimit dhe realizimit të studimit.</p> <p><i>(Evidencat 31-Rregullore e diplomimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Realizimi i temës së diplomës bazohet në rregulloren që departamenti ka përpiluar në mënyrë specifike për mbrojtjen e diplomës. Ky dokument emërtohet. Institucioni i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësore ku realizohet studimi ose realizojnë</p>

	<p>pjesën eksperimentale në laboratorët e departamentit. Leja etike për realizimi e studimit jepet nga dekanati i FSHM.</p> <p><i>(Evidenca 78-Udhëzues për punimin e Diplomës).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i provimit të diplomës apo temës bëhet me notë. Teza korrigjohet nga komisioni. Proçes verbali përfundimtar firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari.</p> <p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara jurisë së komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Prezantimi i temës së diplomës është i hapur dhe koha e prezantimit është 30 minuta. Pas prezantimit paraqesin mendimin oponentët dhe udhëheqësi i studimit.</p> <p>Tema e diplomës vlerësohet me pikë individuale nga secili anëtar i komisionit dhe në fund llogaritet mesatarja aritmetike. Në përfundim të proçesit të provimit, Kryetari i Komisionit të provimit hedh rezultatet e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Proçesverbali i gjeneruar nga sistemi, nënshkruhet nga kryetari dhe një anëtar i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe dorëzohet në sekretari.</p> <p><i>(Evidencat 31-Rregullore e diplomimit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori.</p> <p>Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Infermieri” Proçedura që ndiqet për tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit. Studenti paraqet kërkesën në sekretari, kryhen pagesë në bankë dhe tërheq dokumentat e programit të studimit në departament brenda 10 ditëve pas dorëzimit të pagesës.</p> <p><i>(Evidencat 31-Rregullore e diplomimit, 86-Format diplome dhe suplementi,)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretariatë mësimore të fakultetit gjendet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i vlerësimeve të mara nga studentët gjatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave.</p> <p>GVJ verifikoi dokumentacionet e depozituara në sekretarinë mësimore dhe i gjeti në përputhje me kërkesat e ligjit.</p> <p><i>(Evidencat 87-Vendim i SA për miratimin e rregullores së arshivë-protokollit, 88-Rregullore e sekretarisë mësimore, Dosjet e verifikuara gjatë vizitës në sekretari)</i></p>

Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Bachelor në "Infermieri" dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Departamenti përgjegjës i programit të studimit është Departamenti i Infermieristikës. Në tre vitet akademike 2021-2024 përbërja e stafit akademik është si vijon:</p> <p>Në këtë fakultet aktivizohen një numër optimal personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), si dhe personel ndihmës akademik (PNA), specialistë të fushave që mbulon secili departament:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Viti akademik 2023 – 2024 <ul style="list-style-type: none"> - PAE 27, të kategorive: 5 Prof., 3 Prof. Asc., 14 Dr., 5 Msc. - PAK 47, të kategorive: 9 Prof., 7 Prof. Asc., 23 Dr., 8 Msc. - PNA 5 2. Viti akademik 2022 – 2023 <ul style="list-style-type: none"> - PAE 25, të kategorive: 6 Prof., 6 Prof. Asc., 12 Dr., 1 Msc. - PAK 58, të kategorive: 8 Prof., 8 Prof. Asc., 19 Dr., 23 Msc. - PNA 5 3. Viti akademik 2021 – 2022 <ul style="list-style-type: none"> - PAE 24, të kategorive: 8 Prof., 4 Prof. Asc., 10 Dr., 2 Msc. - PAK 40, të kategorive: 5 Prof., 4 Prof. Asc., 12 Dr., 19 Msc. - PNA 5 <p>Departamenti i Infermierisë që ofron programin e studimit angazhon në mësimdhënie personel akademik me kualifikim kryesisht të fushës së mjekësisë dhe infermierisë të shpërndarë në vite si më poshtë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Viti akademik 2023 – 2024

	<ul style="list-style-type: none"> - PAE 11, të kategorive: 1 Prof., 2 Prof. Asc., 3 Dr., 5 Msc. (1 në proces Doktorature) - PAK 19, të kategorive: 3 Prof., 2 Prof. Asc., 9 Dr., 5 Msc. - PNA 2 <p>2. Viti akademik 2022 – 2023</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE 9, të kategorive: 1 Prof., 3 Prof. Asc., 4 Dr., 1 Msc. (në proces Doktorature) - PAK 31, të kategorive: 4 Prof., 1 Prof. Asc., 7 Dr., 19 Msc. (1 në proces Doktorature) - PNA 2 <p>3. Viti akademik 2021 – 2022</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE 8, të kategorive: 2 Prof., 2 Prof. Asc., 2 Dr., 2 Msc. (1 në proces Doktorature) - PAK 22, të kategorive: 3 Prof., 2 Prof. Asc., 9 Dr., 8 Msc. - PNA 2 <p>Ndërsa staf akademik përgjegjës për këtë program studimi është i ndarë si më poshtë:</p> <p>1. Viti akademik 2023 – 2024</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE 19, të kategorive: 3 Prof., 3 Prof. Asc., 8 Dr., 5 Msc. - PAK 22, të kategorive: 3 Prof., 3 Prof. Asc., 10 Dr., 6 Msc. <p>2. Viti akademik 2022 – 2023</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE 17, të kategorive: 2 Prof., 4 Prof. Asc., 6 Dr., 5 Msc. - PAK 17, të kategorive: 2 Prof., 3 Prof. Asc., 10 Dr., 2 Msc. <p>3. Viti akademik 2021 – 2022</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE 10, të kategorive: 2 Prof., 2 Prof. Asc., 4 Dr., 2 Msc. - PAK 27, të kategorive: 4 Prof., 3 Prof. Asc., 8 Dr., 12 Msc. <p>Institucioni ka kapacitetet infrastrukturore (laboratorë, mjete audiovizuale, auditorë) për zhvillimin e programit të studimit. Në tre vitet e fundit numri i stafit akademik në department ka qënë stabil. <i>(Tabelat 1, 6, 7, 8, 16, 17 të RVB, Evidenca 17-Raporti vjetor për vitin akademik 2021 – 2022, 2022 – 2023, CV e personelit akademik, vizita dhe takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e programit Bsc në Infermieri e, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike</p> <p>Shpërndarja e ngarkesës së stafit akademik realizohet bazuar në udhëzimin nr 29/2018, për veprimtarinë mësimore të personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë ku cdo personeli akademik angazhohet në bazë të kualifikimit dhe gradave e titujve akademike përkatës.</p> <p>GVJ konstaton se nuk përmbushet kriteri ligjor sipas të cilit 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohet nga PAE. Nga analiza e</p>

	<p>tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton se PAE mbulon 55.4% dhe PAK 44.6%.</p> <p><i>(Evidencat 34-CV e personelit akademik, 36-Të dhëna statistikore të personelit akademik, Tabelat 2, 4, 6, 8 të RVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion e shqyrtuar në drejtorinë e burimeve njerëzore, Departamentit, ku zhvillohet program i studimit si dhe CV e stafit akademik konstatojmë se në tre vitet e fundit stafi akademik është stabël. Nga shqyrtimi me sondash i kontratave të punës konstatojmë se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>(Takimi me zyrën e burimeve njerëzore, Evidenca 92 . Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UNI LUARASI. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme realizohen nga njesia bazë duke propozuar komisione Ad-hoc conform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore të UNI LUARASI . Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi. Nga shqyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar.</p> <p>Konkretisht ,dosja e stafit akademik përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit. 2. Librezën e punës 3. CV 4. Listë notash, Diplomë, Diplomë gjuhë të huaj, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor 5. Fotokopje ID 6. Procedurën e punësimit 7. Vlerësimin e fazës së konkursit <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UNI LUARASI dhe kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga</p>

	<p>lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e UNI LUARASI dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kritere për rekrutimin e personelit.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore.</p> <p>Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit. Pasi miratohen vendet e lira të punës shpallen në faqen e ËEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithsme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet çdo kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit.</p> <p>Pas shpalljes së vëndit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurimi kalon ne dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vleresim në bazë të dosjes 2. Intervista gojore <p>Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim, Institucioni realizon vlerësim të vazhdueshëm duke shfrytëzuar zhvillimin e pyetësorëve të studentëve dhe formularët e vetëvlerësimit.</p> <p>Zyra e burimeve njerezore e cila administron gjithë të dhënat në lidhje me personelin akademik përditëson dosjet në mënyrë periodike bazuar ne një format standart.</p> <p><i>(Evidenca 93: Rregullore e Zyrës së burimeve njeëzore.Evidenca 86: Format i dosjes së personelit.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik në përputhje programin dhe kualifikimin përkatës. Përsonele ndihmës akademik asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirembajtjen e laboratoreve</p> <p>Laboratori i kimisë, Laboratori i biologjisë, biokimisë, mikrobiologjisë. Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.</p> <p><i>GVJ evidentoi që institucioni nuk disponon laborator të infermieristikës i cili i dedikohet posacërisht studentëve të këtij programi.</i></p> <p><i>(vizitë në ambjente)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem, GVJ konstatoi se UNI LUARASI, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Bsc Infermieri”.</p>

<p>përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban edhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër si dhe dosjen personale për stafin jo akademik. Gjithashtu në dosjet e personelit gjendet të dhëna për aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor të pësonelit.</p> <p>Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka venë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Të dhënat e përditësuara shërbejnë gjithashtu për realizimin e analizave dhe të raporteve institucionale.</p> <p><i>(Evidenca 98: Dosja e punonjësit UNI Luarasi. Evidenca 34: CV personeli akademik Bachelor në Infermieri)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit, FSHM dhe UNI LUARASI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor.</p> <p>Konkretisht GVJ evidentoi që UNI LUARASI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet të tilla, siç janë:</p> <p>Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, INTERMEDIKA, Genius Lab, Klinika Hipokrati, Klinika Akili, Klinika Ama Vita, Spitali Universitar i Traumës.</p> <p>Këto institucione në bazë të marrëveshjeve caktojnë personel të kualifikuar dhe të dedikuar, me qëllim ndjekjen, instruktimin dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë orëve praktikës profesionale me qëllim plotësimin e objektivave specifike të saj me qëllim përfundimtar arritjen e kompetencave profesionale të infermierëve të ardhshëm. Përgjegjësi i departamentit cakton një koordinator me qëllim mbikëqyrjen e tërë procesit përfshirë përcaktimin e institucioneve, shpërndarjen dhe organizimin e studentëve së bashku me përcaktimin si të mbikëqyësve përkatës në institucionin pritës ashtu edhe të personelit akademik i cili do ndjekë procesin.</p> <p>Këto marrëveshje përveç se kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale ato mund të shërbejnë edhe për realizimin e punimeve të diplomës për studentët të cilët plotësojnë kriteret.</p> <p>Për këta studente institucioni gjithashtu vë në dispozicion burime të mjaftueshme mbështetëse si akademike ashtu edhe logjistike.</p> <p><i>(Evidenca 40: Lista e studentëve sipas institucioneve ku do kryhet praktika profesionale, Evidenca 31: Rregulloret e Diplomimit, Evidenca 101 :Shembull, ditar i praktikës profesionale)</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e</p>	<p>Institucioni ka përpiluar dokumentacionin përkatës në lidhje me detyrimet e personelit i cili realizon mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikave profesionale, pikërisht Udhëzuesin e Praktikave dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Pasqyren e Praktikës. Në marrëveshjet me Institucionet Shëndetësore, përcaktohen qartë kërkesat ndaj institucioneve në të cilat realizohet praktika që nga ofrimi i asistencës profesionale mësimore, përcaktimi i tutoreve, aksesit në mjedisë dhe procedurat infermierore etj. Në fund të realizimit të praktikës mbikqyrësi përkatës plotëson formularin përkatës të vlerësimit për çdo student.</p> <p><i>(Evidenca 100: Pasqyrë për praktikën mësimorë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Evidenca 102: Formular vlerësimi nga institucioni pritës)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për realizimin e programit Bachelor në Infermieri , IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. GVJ konstatoi se IAL nuk zbaton aspektin ligjor mbi ngarkesën e stafit akademik, ku rezultoi se PAE nuk mbulon 70% të ngarkesës.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se UNI LUARASI, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit "Bsc Infermieri". Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHM dhe UNIEL disponon mjedise të pamjaftueshme brënda institucionit pasi mungon laboratorit i infermieristikës, ndërsa ka lidhur me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor marrëveshjeve të bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UNI LUARASI.</i></p> <p><i>Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike</p>	<p style="text-align: center;">Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Gjatë vizitës në instucion GVJ u njoh më mjediset e UNI LUARASI . Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar dhe gjatë vizitës në institucion GVJ evidentoi që UNI LUARASI ka në funksion të procesit akademik dhe</p>

<p>të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>akomodimit të studentëve , personelit administrativ dhe akademik ambjente të mjaftueshme sic janë :</p> <p>Sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambjente për personelin akademik, ambjentë për personelin ndihmës, ambientet ndihmëse , ambjente çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë , ambjente teknike si dhe hapësirë të jashtme.</p> <p>Njësia bazë ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarise mesimore në përputhje me numrin e studentëve duke organizuar edhe orarin mësimor në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në Infermieri.</p> <p>(Evidenca 103: Infrastruktura e universitetit Luarasi. Evidenca 104 :Guida Infrastrukurore-Kapacitetet pritëse 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raport me numrin e posteve në sallë. Ambjentet mësimore janë me sistem kondicionimi ngrohje dhe ftohje. Ambientet e FSHM kanë nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës on line në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksioin të programit janë në dispozicion mjete elektronike dhe teknologjise së informacionit, si kompjutera dhe videoprojektorë kryesisht në sallat e leksioneve. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.</p> <p>Studentet kane akses në rrjetin LAN dh e gjithë godina është ë mbuluar me ëi-fi. Institucioni disponon intranet i ndertuar mbi një platformë si Sharepoint. Bazuar në këtë shërbim personeli akademik ka mundësi të menaxhoje dokumentacionin dhe informacionin brenda institucionit. Institucion disponon një platforme e-learning e cila lehtëson shperndarjen dhe këmbimin e materialeve mesimore mes studentëve dhe pedagogeve. Sistemi i brendshëm informatik krijon mundësinë e ruajtjes dhe gjenerimit të të dhënave për të gjithë studentët e regjistruar.</p> <p>(Evidenca 103: Infrastruktura e Universitetit Luarasi, vizita e ambienteve)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme</p>	<p>FSHMT zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Infermierise apo departamante të tjera të FSHMT duke plotësuar pjesërisht kërkësat e moduleve dhe objektivave specifik formues të këtij programi studimi.</p> <p>Njësia Kryesore disponon :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Laboratorin e Kimisë dhe Farmacisë

për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<ul style="list-style-type: none"> – Laboratorin e biokimisë-biologjisë-fiziologjisë-mikrobiologji – Laboratorin e Stomatologjisë <p><i>Institucioni nuk disponon Laborator të infermieristikës, i cili i dedikohet pocacerisht programit BSC në Infermieri.</i></p> <p>Laboratorët funksionojnë në bazë të rregulloreve përkatëse duke përbmushur kushtet e sigurisë dhe përdorimit sipas standarteve.</p> <p><i>(Evidenca 103: Infrastruktura e Universitetit Luarasi. Evidenca 97 Rregullore për përdorimin e Laboratorëve të Infermierisë.)</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>Institucion disponon 4 (katër) laboratore të teknologjisë së Informacionit , me rreth 120 PC , të cilët janë edhe në funksion të programit të studimit në Bachelor në Infermieri të Përgjithshme Këto laboratorë janë të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për zhvillimin e laboratorëve të modulit të Informatikës.</p> <p><i>(Evidenca 62: Rregullore për përdorimin e Laboratorëve të Infermierisë)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</i></p> <p><i>FSHM zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Infermierise apo departamante të tjera të FSHM. Në funksion të programit të studimit në Bachelor në Infermieri të Përgjithshme janë vënë Laboratorë të Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>GVJ evidenton që institucion nuk disponon një Laborator të dedikuar të Infermieristikës dhe inkurajon për ngritjen e një laboratori të tillë i cili ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse <i>pothuajse të mjaftueshme</i> në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>

	<p><i>GVJ evidentoi që biblioteka e UNI LUARASI gjendet një numër i kufizuar titujsh mjekësor si në shqip ashtu edhe në gjuhe të huaj. Sidomos literatura në shqip është e kufizuar.</i></p> <p>GVJ rekomandon që studentët të kenë literaturën në gjuhën shqipe si literaturë bazë e vënë kjo në dispozicion edhe në formën e dispencave të leksioneve të redaktuara dhe të aprovuara nga departamenti dhe njesia kryesore.</p> <p><i>(vizitë e ambjentëve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve më Stafin Drejtues, u deklarua që që cdo fillim viti akademik titullari i lëndes/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Infermieri e programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Sic u theksua dhe me lart <i>gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar. I njëjti fenomen u evidentua gjatë vizitës shqyrtimit të kurrikulave, GVJ evidentoi që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar.</i></p> <p>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogëve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UNI LUARASI ,për rritjen e buxhetimit apo sigurimin e burimeve të tjera me qëllim pasurimin e metejshëm të fondit të bibliotekës.</p> <p><i>(vizitë e ambjentëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ evidentoi që biblioteka është vendosur në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm nga studentet dhe pedagogët duke i krijuar atyre mundësi të barabarta shfrytëzimi. Biblioteka ka 20 poste studimi me akses në internet. <i>Siperfaqia e bibliotekës nuk është e bollshme (43 m2) , por gjatë vizitës në Institucion na u referua që studentët kanë edhe ambiente të tjera në funksion të studimit si sallat e seminareve apo laboratorët e informatikës të cilat janë të hapura deri në orën 19 të darkës.</i></p> <p><i>(vizitë e ambjentëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit është e paisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka nje fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra apo revista shkencore. <i>Megjithatë GVJ, ashtu sic parashtrijë edhe më sipër problematikën e titujve të pakët dhe vjetëruar, rekomandon që biblioteka duhet të pasurohet më tej me botime të fundit dhe me tituj të rinj.</i></p> <p><i>(vizitë e ambjentëve)</i></p>

specifikës së programit të studimit.	
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UNI LUARASI ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line.</p> <p>UNI LUARASI është pjesë e U –Library vënë në dispozicion nga RASH. Literatura bazë nga studentët aksesohet edhe nga sistemi Luarasi Moodle LMS/ Teams. Literatura dhe shërbimet online janë gjithmonë në shërbim të studenve dhe platforma e-learning funksionon gjate 24 –orëve.</p> <p><i>(Evidenca 110 : eëë.ulibrary.rash.al)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e informatizuar duke krijuar një qasje efektive nga saj të studentëve dhe stafit akademik. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar dhe i përpunuar sipas standarteve bibliografike nderkombëtare. Cdo student ka një kartelë rregjistrimi me qëllim sigurimin e literaturës dhe sigurimin e aksesimit të sistemit të kompjuterizuar të bibliotekës. Gjithsesi, hapsira e bibliotekës është një problem duke pasur në konsideratë nr e studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 64: Manuali përdorimit- Sistemi I menaxhimit online I bibliotekës. Evidenca: 111 Formulari I aplikimit dhe marrveshja për anetaresimin online)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 8. 30- 20.00 cdo ditë të javës, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Gjatë periudhave kur ka rritje të kërkesës sic janë periudhat e provimeve, biblioteka zgjeron oraret dhe gjithshu krijon mundësi për mjedis shtesë punë. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 105: Rregullore e bibliotekës , miratuar nga VSA nr 11/2024)</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me stafin e bibliotekës GVJ evidentoi se bëhën raportime të vazhdueshme në lidhje me fondin e bibliotekës si në hard cop ashtu dhe on-line. UNI LUARASI planifikon do vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekse vijnë nga departamente e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e tekseve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Në analizën vjetore të UNI jepen të dhëna në lidhje me buxhetimin dhe numrin e titujve te cilët janë ne rritje, nuk ka të dhëna</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>konkrete në lidhje me shfrytëzimin e sallave të studimit apo të shfrytëzimit të literaturës on line, gjatë bisedës me stafin akademik dhe studentët u deklarua se ata e shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme fondin e e bibliotekës kryesisht atë on-line.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNI LUARASI ka një Bibliotekë Universitare të pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme. Nga ana e GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 8.30⁰⁰-20⁰⁰ cdo ditë të javës. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse pothuajse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. UNI LUARASI ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. GVJ evidenton që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekesore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar. GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogëve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UNI LUARASI .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Informacionin në lidhje me studentët që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre Institucioni e menaxhon me anë të sistemit të informatizuar të kontratave. Sekretaria mesimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkresore dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave personale dhe financiare të studentit. Ky sistem lehtëson procedurat e regjistrimit dhe gjenerimit të kontratave dhe gjithashtu i shërben studeve eksistues dhe administratës për përpilimin e raporteve përkatëse.</p>

	<p>Të dhënat akdemike menaxhohen me anë të sistemit Luarasi Moodle-LMS dhe ne bazë të marrveshjes me RSH përdoret sistemi PITAGORA, sistem në të cilin Institucioni ka kaluar krejtësisht. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merrinformacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoi apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregjistri themelatrë të studentëve • Rregjistri me të dhënat akademikë • Rregjistri i lëshimit të diplomave <p>Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjith dokumentacionin përkatës • Proçes verbalet e testime në provime . • Dosjet e diplommit; • dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës • listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p><i>(Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-Moodle-Teams tutoriale. Evidenca 33. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga studenti. ;Vizita ne sekretarine mesimore)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik , ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, Sharepoint platformë e pershtatur nga Microsoft. Stafii akademik dhe studentët kanë akses për infomacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu UNI LUARASI përdor sistemin e ngarkesës së pedagogve sistem i cili mbeshtët stafin akademik dhe drejtues në cdo lëndë dhe modul.</p> <p>Sistemit Luarasi Moodle-LMS është tashmë i përditsuar dhe realizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rregjistrimin e studentë sipas lëndëve – Rregjistrim e lëndëve sipas programit dhe moduleve – Rregjistrimi e pedagogeve përgjegjës përcdo lëndë. <p>Ky sistem ofron mundësinë e organizimit të gjithë procesist të mësimdhënies duke përfshirë detyrat e kursit, pyetësoret , aktivitet akademik , aktivitete shkencore etj. Ky sistem i menaxhimit i siguron</p>

	<p>akses të dedikuar në informacione e dokumente të gjithë studentëve dhe pedagogëve.</p> <p><i>(Evidenca 33. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga studenti.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sic u theksua dhe më lart sistemi Luarasi Moodle-LMS krijon mundësi dhe lehtësi komunikimi mes studenteve, pedagogëve dhe jo vetëm. Platforma mundëson jo vetëm shkëmbimin e informacionit por edhe menaxhimi i tij sic është depozitimi, raportimi, shpërndarja etj.</p> <p>Cdo student dhe pedagog ka llogarinë e tij të përdoruesit dhe ka akses të dedikuar sipas statusit përkatës. Komunikimi me anë të këtij sistemi është inter-aktiv ku studentët mund komunikojnë me pedagogët për cdo paqartësi, orientim apo konsultim.</p> <p><i>(Evidenca 41. Urdhër për përdorimin e platformës Pitagora.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit intranet përmban edhe sistemin e menaxhimit të ngarkesës së pedagogëve, sistem i cili krijon mundësinë e kontrollit dhe vlerësimit në kohë reale të realizimit të ngarkesës mësimore dhe mbarëvajtjen e tërë procesit akademik. Sistemi i menaxhimit Luarasi Moodle-LMS përveç funksioneve të sipër cituara shërben dhe si mjet monitorimi i procesit akademik por edhe si një sistem raportimi për organet drejtuese.</p> <p>Sistemi mundëson gjenerimin e të dhënave statistikore, realizimin e raporteve duke i mundësuar palëve të interesuara vlerësimin real të mbarëvajtjes akademike dhe vendmarrje të argumentuar.</p> <p><i>(Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-Moodle-Teams tutoriale.</i></p> <p><i>Evidenca 43. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga Sekretaritet Mësimore.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja Zyrtare e Universitetit "LUARASI " është : www.luarasi-univ.edu.al.</p> <p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UNI, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UNI LUARASI dhe fakultete, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionon UNI LUARASI, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj.</p> <p><i>Faqja zyrtare në web aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës në IAL na u referua se faqja në gjuhën angleze është në zhvillim.</i></p> <p><i>(Faqja zyrtare www.luarasi-univ.edu.al. Verifikuar nga GVJ)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNI LUARASI disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe</i></p>

	<p>aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët, cdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore dhe stafi drejtues.</p> <p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare në ëeb aktualisht është vetëm në gjuhën shqipe, faqja në gjuhën angleze është në zhvillim proces të cilin GVJ e inkurajon.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik UNI LUARASI harton cdo vit një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Raportet hartohen në bazë institucion dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike.</p> <p>Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë bazë dhe më tej njësi kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik. Cdo njësi bazë dhe njësi kryesore harton analizën vjetore ku pjesë është edhe analiza financiare. Ky raport përvec të dhenave të procesit mësimor dhe akademik jep dhe të dhëna në lidhje me shpenzimet , të ardhurat, aktivitetet e jashtëm dhe të brendshme. Këto analiza bëhen pjesë e raportit vjetor që harton institucioni në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë.</p> <p>Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit i cili është gjithashtu i aksesueshëm dhe në faqën zyrtare të institucionit ëëë.luarasi-univ.edu.al.</p> <p>(Evidenca 115 : Raport Auditi 202-2023 . Evidenca 116 :Pasqyrat Financiare 2021-2023. Evidenca 114: Praktika për miratimin e buxhetit 2023-2024)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të</p>	<p>Burimet infrastrukturore dhe njerëzore në UNI LUARASI shfrytëzohen nga të gjitha programet që ofron institucioni, kjo është arsya që plani financiar hartohet në nivel institucional dhe jo të</p>

<p>përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>programit. Ndërsa menaxhimi i shpenzimeve dhe të ardhurave bëhet në nivel të njësisë kryesore.</p> <p>Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo program. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucion mbështet personeli akademik për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe mobilitete. Gjatë takimit me drejtues të departamentit na u referua që Departamenti mbështet anaëtarët e tij burimet e duhura për realizimin e punës kërkimore shkencore.</p> <p><i>Por GVJ nuk gjen të dhëna për financimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen për punën kërkimore shkencore të pedagoqeve, por ne mendojmë dhe inkurajojmë Institucionin që të devijojë apo të punojë më shumë për sigurimin e fondeve kërkimit shkencor dhe investimit në laboratore me qëllim kërkimor kryesisht ë fushën e mjekësisë.</i></p> <p>UNI LUARASI , është pjesë e Hysenbelliu grup dhe kryen auditim të përvitshëm. Të dhënat financiare paraqesin pozicionin financiar të të shoqërisë në përputhje me Standartet kombëtare të kontabilitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare (grante, projekte) për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet.</p> <p><i>(Evidenca 115 : Raport Auditi 202-2023 . Evidenca 116 :Pasqyrat Financiare 2021-2023. Evidenca 114: Praktika për miratimin e buxhetit 2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të</p>	<p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit , investimeve, shërbimeve etj .</p> <p><i>(Evidenca 115 : Raport Auditi 202-2023 . Evidenca 116 :Pasqyrat Financiare 2021-2023. Evidenca 114: Praktika për miratimin e buxhetit 2023-2024)</i></p>

posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	Çdo vit akademik UNI LUARASI harton cdo vit një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. UNI LUARASI , dhe kryen auditim të përvitshëm. Të dhënat financiare paraqesin pozicionin financiar të të shoqërisë në përputhje me Standartet kombëtare të kontabilitetit. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit , invetimeve, shërbimeve etj .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti “ LUARASI” dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore kanë hartuar Statutin dhe Rregulloren në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Në rregulloren e departamentit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon Zyra e Studentit, Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe gjithashtu sekretaritet mësimore në nivel të njësisë kryesore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>(Evidenca 1: Statusi i Universitetit Luarasi . Evidenca 2: Rregullore e brendshme e Universitetit Luarasi . Evidenca 46 : Praktika e plote per FSHMT: Per propozim e kriterëve per pranimin e studentëve në programin e studentëve)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	FSHM ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. <i>(Evidenca 1: Statusi i Universitetit Luarasi . Evidenca 2: Rregullore e brendshme e Universitetit Luarasi.)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Para cdo viti akademik pas kërkesës së MASR, institucion përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit në programin e ciklit të parë në programin e studimit Infermieri. Kushtet dhe kriterete për përzgjedhjen e kandidatëve publikon para cdo viti akademik në faqen ëeb të Institucioni dhe gjithashtu ia bëhen të ditura kandidatëve për studente edhe gjatë kontakteve të drejtpërdrejta. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike dhe propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga njësia kryesore Kriteret dhe kuotat e regjistrimit miratohen përfundimisht nga Senati Akademik i cili i dërgon në bazë të legjislacionit në fuqi MASR. Në këto kriterë përfshihen dhe parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj. <i>Për programin e studimit Infermieri GVJ evidenton që institucioni nuk ka përcaktuar kriterë specifike, përveç kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit.</i> Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve. <i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024.</i> <i>Evidenca 46: Praktika e plote e FSHM: Per propozimin e kriterëve për pranimin e studentëve në programin e studimit)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në statutin e Institucionit, në faqen ëeb dhe gjithashtu në broshurën informuese janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për: <ul style="list-style-type: none"> – Organizimin e programeve të studimit – Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë – Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave – Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi – Rregullat e ekuivalentimit etj.

	<p>Rregullorja e Njesisë Kryesore, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrier, zyrës së studentit, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statut dhe rregulloren e departamentit përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 118. Udhërrëfyeti i studimit 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni informon publikun dhe të interesuarit me anë broshurave informuese, rrjeteve sociale, faqes ëeb në internet dhe gjithashtu publiciteti në rrjete televizive. Faqja zyrtare e institucionit përditësohet në mënyrë të vazhdueshme duke dhënë informacione të detajuara ë lidhje me të gjitha aspektet e Institucionit dhe gjithashtu të programit të studimit Bachelor në Infermieri.</p> <p><i>(Evidenca 118: Udhërrëfyeti i Studimit 2021-2022;2022-2023;2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni deklaron se inkurajon regjistrimin e studentëve nga trojet me aftësi të vecanta dhe shtresat e marginalizuara. GVJ nuk gjen evidenca të kriterëve specifike për këto shtresa studentesh apo parashikim të kuotave të vecanta për këto kategori.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, UNI LUARASI dhe Departamenti harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS ku specifikohet ekuivalentimi i diplomës së shkollës së mesme. Duke qënë së programi zhvillohet vetëm në gjuhën shpise vlerësojmë se vendet nga të cilat mund të vijjnë kandidatë janë të kufizuara.</p> <p><i>(Evidenca 11: Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Infermieri)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të</p>	<p>UNI LUARASI, çdo vit akademik bazuar në rregulloren për bursat studentore, harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselente ne varësi të</p>

<p>rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>aritjeve akademikeve. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UNI LUARASI.</p> <p>Nw bazw tw statistikave ne FSHM janw dhwnw gjithsej 8 (tetw) bursa sociale , por GVJ nuk gjen specifikime pwr cilat programe studimi (Evidenca 119 : Rregullore për bursat studentore. Evidenca 120 : Statistika për bursat 2021-2022. Bursat studentore 2021-2023)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara, dhe po ashtu sipas Udhezimeve të Ministrisë së Arsimit. Për programin e studimit Bachelor në Infermieri e GVJ evidenton që institucioni nuk ka përcaktuar kriterë speifike, përvec kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</i></p> <p><i>UNI LUARASI , cdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë për studentët ekselente ne varësi të aaritjeve akademikeve, dhe për studentët nga shtee të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Frekuentimi i leksioneve, 50% 2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%. 3. Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshem ne masen 100%. 4. Frekuentimi i praktikave profesionale /mesimore/ spitalore është i detyrueshem ne masen 100%. Në këtë program studimi nuk parashikohet kushtezim midis lendeve. Në sekretarine mesimore te FSHM mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mesimor nga studentet e cdo grupi mesimor, i cili plotësohet për cdo orë mësimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin.



	<p>Rregullorja i vihet ne dispozicion studenteve nga strukturat drejtuese , si dekani përgjegjesi i departamentit dhe stafi akademik gjatë javës së orientimit. Gjithashtu informacion i detajuar jepet nga pedagogët e lëndës sipas parashikimeve të syllabuseve përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024. ; Evidenca 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Infermieri; Evidenca 75. Java e orientimit për studentët e rinj.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në rregullore ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme përmes sekretarisë mësimore për të gjitha procedurat, sic janë kushtet e pranimit , mënyra e vlerësimit dhe njohjes së krediteve, proceduren e transferimit etj.</p> <p>Studentet paraqesin kërkesen dhe tërë dokumentacionin e nevojshem në bazë të statutit të Institucionit dhe rregullores ë programit të stumit. Në departanent ngrihet një komision i posatshtëm i aprovuar nga dekani, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Ekuivalentimi realizohet në nivel të njësisë bazë.</p> <p><i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024. Evidenca 45. Praktika për transferimin e studimeve, FSHM.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuar në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar. Institucioni informon studentët mbi format e studimeve dhe mënyrën e vlerësimit duke i orientuar për tu konsultuar me rregulloren e programit dhe syllabuset e cdo lënde, matëriale të cilat vihen në dispozicion të cdo studenti.</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve/provimeve me shkrim/ me goje/ projekteve/ prezantimeve/ praktikave.</p> <p>Në programin e lëndeës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studenteve me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>Në syllabuse përcaktohet në mënyrë të detajuar pragu i pikëve kaluese dhe konvertimi i pikëve në nota. Në takimin me studentët GVJ</p>

	<p>konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit.</p> <p><i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024. neni 22)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e fakultetit, rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë kushtet dhe të gjitha procedurat e diplomimit. Për të qënë sa më transparente dhe për të lehtësuar procesin Institucioni gjithashtu ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Në rregullore përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome <ol style="list-style-type: none"> 1. Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimit dhe rivlerësimit. 2. Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës. - Kushtet që duhet të përmbushë student për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës). Në fillim të vitit të fundit të studimeve, njësia bazë ne bazë të suksesit së dy viteve të para përcakton studentët të cilët mund të mbyllin studimet me temë diplome.</p> <p><i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024. neni 34-39)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes faqes zyrtare, rrjeteve sociale, publicitetit në televizionin Neës 24 dhe fletë palosjeve informuese. Gjithashtu institucioni harton broshura të dedikuara për cdo program studimi ku përveç informacionit për strukturën e programit jepen informacione për mundësitë e karrierës dhe mundësitë e vazhdimit të mëtejshëm të studimeve.</p> <p>UNI LUARASI merr pjesë aktive në panairët e arsimit të cilat zhvillohen cdo vit në shumë qytete të Shqipërisë. Një rol të rëndësishm luan edhe Zyra e Sekretarisë Mësimore i cila është në dispocion për dhënie e cdo informacioni kandidateve për studente.</p> <p>Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</p> <p><i>(Evidenca 118. Udhërrëfyysi i studimit 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024;</i></p>

	<i>Evidenca 121 www.panorama.com.al. luarasi në panairin ëork and study; Evidenca 88. Rregullore e Sekretarisë Mësimore”)</i>			
Konkluzione	<p><i>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin dhe gjithashtu është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</i></p> <p><i>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar. Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës. Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve, faqes zyrtare, publicitetit në televizion . Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb të UNIEL. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rrealizon gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët që ndjekin programet mësimore Bcs në Infermieri informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Ky proces realizohet në javën e orietimit përmes Njësië Bazë, Personeli Akademik dhe Sekretaria Mësimore ku informohen mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit – Informacion për objektivat formuese të programit – Strukturën dhe organizimin e programit – Planin mësimor – Syllabuset – Rregulloren – Suplementin e diplomës <p>Për lehtësimin e këtij procesi , studentët kanë në dispocion edhe në formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë sekretarisë mësimore të FSHM. Studentëve u jepen broshura me të gjitha</p>

	<p>informacionet rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së programit.</p> <p><i>(Evidenca 75: Java e orientimit për studentët e rinj)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studentit gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studentit orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë) mënyra e vlerësimit etj. Informacioni vihet në dispozicion përmes sekretarisë mësimore, Zyrës së Studentit, koordinatorit të programit dhe sigurisht një peshë shumë të rëndësishme mbajnë titullarët e lëndëve dhe moduleve të cilët janë në kontakt të përditëshëm dhe intensiv me studentët.</p> <p><i>(Evidenca 11. Rregullore Bachelor” në “Infermieri” e miratuar me VSA nr.1-2024; Evidenca 118. Udhërrëfytyesi i studimit 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024; Evidenca 14. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Infermieri.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me operatorë mjekësore dhe me Operatorin e Shërbimit të Kujdesit Shëndetsor, ku jo vetëm marrin informacion për vendet e lira të punës por rrisin mundësinë e punësimit në bazë të performacës gjatë praktikave profesionale.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila funksionon në bashkëpunim me këshilluesit e karrierës, Zyra e Studentit dhe organizimi i panairëve të punës.</p> <p>Gjatë bisedës me studentët dhe përfaqësues të zyrave GVJ eventoi që kontaktet me studentët janë të vazhdueshme dhe ato informohen vazhdimisht mbi mundësitë e punësimit, praktikave, dhe aktiviteteve të tjera të cilat rrisin kompetencën e tyre dhe i përgatisin si për tregun e brendshëm ashtu dhe atë të jashtëm.</p> <p><i>(Evidenca 124: Udhëzues nga Zyra e këshillimit të karrierës , Aplikimit për punë ; Evidenca 122. Rregullore e Zyrës së Studentit 2023-2024)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Ky informacion është në dispozicion të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Sic u theksua më lart Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në instucione shëndetësore dhe spitalore. Në funksion të</p>

	<p>studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. Kështu zyra e sekretarisë mban kontakte të rregullta duke bërë njoftime telefonike ose me anë të e-mailit për çdo event, ndryshim apo problematike. Cdo informacion dinamik në lidhje me procesin akademik dhe shkencor shpërndahet përmes e-maileve dhe Sistemit Luarasi Moodle-LMS .</p> <p><i>(Evidenca 33. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga student; Evidenca 44. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së IT-Moodle-Teams tutoriale.)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UNI LUARASI ka një sistem informatik të brendshëm, përmes të cilit mundësohet informimi studentit për programin e studimit. Institucioni ka ndërtuar dhe ka funksional Portalin e Studentit me anë të cilit studenti ka akses në të gjitha informacion akademik, qasja sigurohet përmes një kod personal në çdo dhënë në çdo moment. Informacioni i detajur dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen web të Instucionit.</p> <p><i>(Evidenca 33. Udhëzues për përdorimin e platformës Pitagora nga studenti.)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët që ndjekin programin mësimor Bachelor në Infermieri informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët eidenton që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Në sekretarinë mësimore të FSHM janë të depozituara dokumentacionet e plota për tërë vazhdimësinë akademike të studentëve të programit të studimit Bachelor në Infermier, sekretaria disponon</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve - Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)

	<p>Ky program studimi ende nuk ka diplomuar dhe të dhënat i takojnë vetëm cilësisë në hyrje dhe vazhdimësisë akademike.</p> <p>Për të gjitha programet e tjera të cilat kanë të diplomuar sekretaria mban regjistrat përkatës dhe përpunon të dhënat në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje, gjithashtu institucioni disponon të dhëna në lidhje me punësimin e studenteve. Këto të dhëna analizohen nga Zyra e Karrierës dhe Zyra e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e raportit vjetor të Institucionit.</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>(Evidenca 17: Raporti vjetor për viti akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, tabelat përmbledhëse)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</p> <p>Për tre vitet e fundit rregjistrimet në këtë program studimi janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 2021-2022, 107 studentë; - Viti akademik 2022-2023, 127 studentë; - Viti akademik 2023-2024, 96 studentë. <p>GVJ evidentoi që në këtë program ka vetëm një student të larguar që nga hapja e tij. Të dhënat e studentëve përditsohen në mënyrë të vazhdueshme dhe sistemi i menaxhimit të brendshëm e lehtëson këtë proces.</p> <p>Në sekretari dosjet e studentëve janë të plotësuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, këtu përfshihen listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të rregjistrimit në programet e dyta dhe të crregjistrimit.</p> <p>(Evidenca 15: Të dhëna statistikore të studentëve të rregjistruar në Bachelor Infermieri)</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit dhe regjistrat.</p> <p>Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit, gjithë dokumentacion ruhet në bazë të legjislacionit në dy forma atë elektronike dhe në hardcopy. Cdo dokument arkivohet dhe ruhet edhe në formë elektronike i skanuar.</p> <p>Akresi në të dhëna është i kufizuar dhe i dedikuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahe vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe në përputhje me</p>

	<p>ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UNI LUARASI. (Evidenca 87: VSA nr 19/2023 Për miratimin e arkiv-Protokollit)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UNI LUARASI deklaron se ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mesimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. Në RVB dhe gjatë takimit më drejtuesit deklarohet se me urdhër të rektorit ngrihen grupe të monitorimit dhe kontrollit të njësive administrative të institucionit sic janë sekretaritë, arkiva etj. Të dhënat e auditimit shërbëjnë jo vetëm për përpilimin e raporteve vjetore por edhe për përmirësimin e tërë procesit me qëllim rritje e saktësisë dhe sigurisë. GVJ nuk gjen dokumentacion konkret të auditimit përveç raporteve vjetore të vlerësimit akademik.</p> <p>(Evidenca 17. Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023 Universiteti Luarasi)</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për cilësinë në hyrje, frekuentimin dhe suksesin akademik. Të dhënat e licensimit parimisht merren nga Urdhëri i Infermierit, duke qënë se ky program nuk ka ende të diplomuar nuk ka ende të dhëna për cilësinë në dalje punësim dhe licensim.</p> <p>(Evidenca 15: Të dhëna statistikore të studentëve të të rregjistruar në Bcs Infermieri)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në sekretarinë mësimore të FSHM janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit. IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i Infermierit por në këtë program studimi akoma nuk ka të diplomuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UNI LUARASI. Në dokumantacion dhe gjatë takimeve në institucion u evidentua që studentët janë të përfaqësuar në Senatën Akademik, NJSBC, Komisionet e përherëshme në nivel institucional. Studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës dhe grupet e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Struktura kryesore është Këshilli Studentor Institucional dhe Këshillat Studentor në nivel Fakultetesh , të cilët luajnë rolin kryesor në përfaqësimin dhe koordinimin e problematikave studentore në organet drejtuese. Roli i këshillave Studentor është i sanksionuar në Statutin e Institucionit.</p> <p><i>(Statuti, Rregullore e brendshme, Evidenca 59: Procesverbal i Këshillit Studentor. Evidenca 130: Rregullore e Këshillit Studentor)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UNI LUARASI ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.</p> <p>Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore.</p> <p>Këshillat studentore luajnë një rol qendror në mbështetjen e studenteve gjatë tërë jetës akademike, problematikave administrative, organizative, financiare etj. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHM. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik.</p> <p><i>(Takimi me Studentet. Evidenca 131: Kërkesa nga studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e</p>	<p>Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor i cili funksion në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHM për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar</p>

<p>kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>problemet që dalin në kohë reale. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Programi Bachelor në Infermieri akreditohet për herë të parë dhe nuk i është nënshtruar procesit të rishikimit, por institucioni i ka funksionale mekanizmat për të përfshirë studentë në këtë proces. <i>(Evidenca 132: Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik, Evidenca 130: Rregullore e këshillit studentor të UL)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimit rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Provimet zhvillohen të sekretuara dhe vlerësimi i pedagogut është i argumentuar. Departamenti organizon seanca sqaruese dhe ka procedur konkrete për ankimin dhe rivlerësim. Kështu departamenti pas procesit të ankimit ngrenjë komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë të përbërë nga, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. <i>(Evidenca 11: Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në dokumantacion dhe gjatë takimeve në institucion u evidentua që studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, NJSBC, Komisionet e përherëshme në nivel institucional. Studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës dhe grupet e vlerësimit të brendshëm. Struktura kryesore është Këshilli Studentor Institucional dhe Këshillat Studentor në nivel Fakultetesh. Studentët kanë qenë pjesëmarrës edhe në hartimin e RVB. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Programi Bachelor në Infermieri akreditohet për herë të parë dhe nuk i është nënshtruar procesit të rishikimit, por institucioni i ka funksionale mekanizmat për të përfshirë studentë në këtë proces.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UNI LUARASI ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zyra e Studenti – Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. – Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. – Zyra e Marrëdhënieve me jashtë – Zyra e Marketingut – Zyra e Marrëdhënieve me Publikun <p>Përmes këtyre zyrave Institucioni realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Një funksion tjetër që ato realizojnë është motivimi i studentëve për pjesëmarrje në ëorkshope, klube studentore, trajnime etj.</p> <p><i>(Evidenca 122: Rregullore e Zyrës së Studentit 2023-2024. Evidenca 123: Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar më lart është funksional dhe i përshtatshëm. Institucioni disponon sisteme të dedikuara si platforma UL Moodle, Pitagora, Microsoft Office, Teams, të cilat sigurojnë informim për studentët. Studentet kanë poste elektronike të dedikuara të formës emer.mbiemër@luarasi-univ.edu.al e cila mundëson një menyrë të centralizuar dhe efikase të komunikimit. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët ndërsa Zyra e këshillimit të karrierës mbështet studentët gjatë procesit të kalimit nga procesi akademik në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>Në institucion funksionon Drejtoria e Këshillimit të Karrierës. Misioni i kësaj zyre është menaxhimi i këshillimit të karrierës të studentëve proces të cilin ajo e realizon përmes mbajtjes së komunikimit me këshillat studentore dhe me tregun e punës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë – Koordinimin e aktiviteteve sic janë trajnimet, konferencat, leksionet e hapura etj. – Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>– Identifikimin e aftësive dhe shprehive profesionale.</p> <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në procesin e këshillimit të karrierës luan vetë personeli akademik i cili duke qënë në kontakt të vazhdueshëm me studentët bën vlerësim më të saktë të kompetanca të studentëve dhe i orienton ato në mënyrë më specifike drejt tregut të punës apo ambicjeve të tjera.</p> <p><i>(Evidenca 123; Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës.)</i></p>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Në takimin e GVJ me Zyra e Këshillimit të Karrierës u informuam se kjo drejtori asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Një nga detyrat e Zyrës së Këshillimit të Karrierës është mbajtja e lidhjeve me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data -bazë të të dhënave të cilat përditësohen cdo vit.</p> <p>Për sa i përket programit Bachelor në Infermieri nuk ka ende të diplomuar dhe rrjedhimisht as informacion për punësim.</p> <p><i>(Evidenca 123; Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës.)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>FSHM ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në institucion funksionon Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të cilat përditësohen cdo vit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një process i rëndësishëm në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. UNI LUARASI ka hartuar një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni ka organizuar gjithashtu edhe trajnime specifike për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive të reja. Gjatë takimit me drejtues u deklarua se është në misionin e institucionit implementimi i metodave të reja të mësimdhënies me qëllim ritjen e cilësisë dhe kompetencave të studentëve. Një rëndësi e vacantë i kushtohet edhe trajnimit të personelit akademik të sapopunësuar me qëllim inegrimin sa më të shpejt dhe nxitjen për aplikimin e risive akademike dhe praktikave të mira. <i>(Evidenca 48: Udhëzues Metodave Inovative të Mësimdhënies. Evidenca 65: Modul Trajnimi Academic Writing Skills)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posatëshme periodikisht programet e studimit dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik. Kështu është ngritur dhe funksionon Sektori dhe Sigurimi të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon në fund të çdo semestri pyetësoret studenteve për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu GVJ evidentoi edhe metoda të tjera të monitorimit sic janë: vëzhgimi i drejtpërdrejtë i pedagogut gjatë procesit mësimor dhe vlerësimi i performancës së pedagogut gjatë vitit akademik. Performanca e stafit akademik bazohet në vlerësimin e procesit të mësimdhënies, aktivitetit shkencor dhe kontributit në punët administrative. <i>(Evidenca 135: Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBC . Evidenca 71: Raport mbi vëzhgimin e paralajmëruar të stafit akademik, Evidenca 72: Formulari i vlerësimit të performancës vjetore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të pedagogut).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, dy herë në vit plotësojnë pyetësoret për vlerësimin e metodave të mësimdhënies. Në fund të çdo viti akademik NJSBC përpilon raportin bazuar në të dhënat e tërhequra nga këta pyetësorë në mënyrë transparente dhe të paanshme. Gjithashtu përfshirja e studentëve të çdo fakulteti me një përfaqësues në NJSBC garanton pjesëmarrjen e tyre aktive në çdo proces të vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor. Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin si të</p>

	<p>institucionit në përgjithësi ashtu është të programeve apo lëndëve specifike.</p> <p><i>(Evidenca 132 : Raportet e pyetësorëve për cdo vit akademik. Evidenca 138: Raport vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sic u theksua dhe më lart pranë UNI LUARASI funksionon Sektori i Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studenteve për matjen e performancës. Në fund të cdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi.</p> <p>Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat përgjegjëse hartojnë një raport në përmbyllje të cdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të institucionit. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015.</p> <p><i>(Evidenca 17 : Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022; 2022-2023)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB deklarohet se Institucioni shqyrton rezultatet e vlerësimeve të cilat i shërbejnë jo vetëm për evidentimin e problematikave por edhe për promovimin e tij . IAL deklaron se duke vlerësuar arritjen e personelit jo vetëm e motivon atë për rritje me të mëtejshme akademike dhe shkencore por gjithashtu këto arritje shërbejnë si shembull për përmirësimin e mësimdhënies duke rritur cilësinë përmes trajnimeve , futjen e metodave inovative etj. <i>Megjithatë GVJ nuk evidentoi raste konkrete të dokumentuar atë promovimit të praktikave të mira në institucion.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional systemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posatshme periodikisht programet e studimit. UNI LUARASI ka hartuar ende një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisione të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. GVJ evidenton që sistemi i sigurimit të cilësisë funksion në rang institucional dhe nuk ka njesi të vecanta në cdo njesi kryesore. Strukturat përgjegjëse hartojnë një raport në përmbyllje të cdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UNI LUARASI -it.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UNI LUARASI dhe në rregulloren e institucionit. Në RVB evidentohet se politikat e sigurimit të cilësisë detajohen dhe në planet strategjike të institucionit. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Në dokumentacion gjejmë evidenca të vendimeve të senatit për aprovimin e Manualit të Cilësisë , për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative, vendime për aprovimin politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë .</p> <p>Të gjitha strukturat drejtuese dhe personeli akademik gjatë aktivitetit të tyre bazohen në përmbushjen e strategjisë institucionale e sanksionuar kjo në statusin e institucionit dhe rregulloret e brendshme.</p> <p><i>(Evidenca 50. Vendim i Senatit Akademik “Për Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”; Evidenca 1. Statuti i Universitetit “Luarasi” nr. 502-2023;</i></p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit “Luarasi”, nr. 17-2023; Evidenca 136. Politikat e UL për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Evidenca 137. Procedurat e UL për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë , e bazon aktivitetin e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015; – Manualin e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë; – Statuti i institucionit; – Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës. <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Pjesë e NJSBC janë anëtare të personelit akademik përfaqësues të katër fakulteteve dhe studentë.</p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve . NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitetsesh:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njërive në nivel institucional. - Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në jësitë bazë. - Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. <p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p> <p>(Evidenca 13. Planit Strategjik i Zhvillimit të UL, për vitet 2021-2025)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UNI LUARASI i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional në vitin akademik 2016-2017 dhe programet e tij janë akredituar ose janë në proces akreditimi. Këto procese kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve.</p> <p>GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC evidenton që institucioni përdor mekanizma të tillë si pyetësorët e vlerësimit të studentëve , vlerësimit të anëtareve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogëve.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UNI LUARASI dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Metodot të cilat aplikohen janë: pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimit, leksione të hapura , intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Kështu vlerësimi i pedagogëve realizohet në fund të cdo semestri të vitit akademik si një indikator i cilësisë dhe etikës në procesin e mësimdhënies. Të dhënat e vlerësimit raportohen në formë hirarkikë deri tek Rektori dhe i referohen në formë konfidenciale edhe pedagogëve.</p> <p>NJSBC përpiqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat sipas gjykimit të GVJ, kanë nevojë të metejshme të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë .</p> <p>Kështu GVJ evidenton se vlerësimet e kryera për mësimdhënien (referuar pyetësorëve për studentin dhe vlerësimin e pedagogëve), janë vetëm përshkruese jo analitike, rezulton se pyetjet janë standarte pa përmbushje të qëllimit final të pyetësoreve.</p> <p>(Evidenca 132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik ; Evidenca 17. Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-</p>

	2023 Universiteti Luarasi; Evidenca 74. Formulari I monitorimit të procesist mësismor të personelit akademik)			
Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC përpiqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat sipas gjyqimit të GVJ, kanë nevojë të metejshme të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>FSHM përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza vjetore e departamentit - Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik - Pyetori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të UNI LUARASI në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve në RVB dhe gjatë diskutimeve me drejtuesit, një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM ku</p>

	<p>koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.</p> <p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC</p> <p><i>Megjithatë, GVJ evidenton se raportimet vjetore janë kryesisht informative dhe jo në kontekstin e përmirësimit të cilësisë apo treguesëve të veçantë të saj. GVJ rekomandon rritje e efikasitetit në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.</i></p> <p><i>(Evidenca 73. Raportet vjetore të NJSBC 2021-2022, 2022-2023; Evidenca 132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSHM. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të UNI LUARASI duke krijuar mundësi me të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave. Por ashtu sic u shprehëm edhe me lart, mendojmë se duhet bërë më shumë punë në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave</p> <p><i>(Evidenca 74 Formulari I monitorimit të procesit mësimor të personelit akademik ; Evidenca 143. Të dhëna statistikore lidhur me rezultatet e studentëve.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p>	<p>Departamentet e FSHP analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Numri i studentëve frekuentues – Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikave – Plotësimi i standarteve të stafit akademik – Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve – Kalueshmëria dhe cilësia semestrale

<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale – Raportet leksion /laborator – Konkluzionet e pyetsorit të studentëve <p>Programi bachelor në Infermieri akreditohet për herë të parë dhe studentet ende nuk i janë nështruar provimit të shtetit për profesionet e rregulluara.</p> <p>(Evidenca 74: Raporti I monitorimit të procesit mësimor në bazë semestri/viti akademik)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim zë informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni përmes kësaj zyre parimisht dhe në mënyrë tradicionale realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit.</p> <p>Programit bachelor në “ Infermieri” akreditohet për herë të parë dhe ende nuk alumni, por Institucioni I disponon mekanizmat që pas daljes së brezit të parë të diplomuarve ti përdorë këto mekanizma vlerësimi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve te ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të UNI LUARASI në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL. Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat</i></p>

	<i>periodike të punës në nivel departamenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë në UNI LUARASI funksionon në nivel Institucional dhe përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, staf me kohë të plotë përfaqësues nga cdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 4 (katër) studentë, edhe këta përfaqësues nga cdo fakultet. Prania e studenteve si anëtarë të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca 135. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBC. Evidenca 144. Tabelë me të dhënat përmbledhëse.)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHP, Përgjegjësit e Departamenteve të Infermierisë dhe Kujdesit Shëndetësor, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese në këtë drejtim. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit “Bachelor në Infermieri”, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, sic është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve.

	<i>(Takimi me studentet. Takimi me stafin . Takimin me anëtarë të NJSBC.)</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të miratuar në institucion. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. <i>(Evidenca 69. VSA nr.4-2024, “Për miratimin e Kodit të Etikës 2024” Evidenca 70. Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të etikës.)</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit institucioni ka përfshirë eksperte të jashtëm, proces të cilin GVJ e inkurajon. Në procesin e vlerësimit institucioni deklaron se realizon takime me bashkëpunëtorë dhe eksperte të jashtëm , të cilët Institucioni në deklaron se japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës. <i>GVJ nuk evidentoi dokumentacion mbështetës për realizimin e këtyre takimeve.</i>			
Konkluzione	<i>Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë në UNI LUARASI funksion në nivel Institucional dhe përbëhet nga 6 (gjastë) anëtarë, staf me kohë të plotë përfaqësues nga çdo fakultet, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 4 (katër) studentë, edhe këta përfaqësues nga çdo fakultet. Rregullorja përfshin përfshirjen e anëtareve të huaj. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkuar dhe koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0) 4 222-43 423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.</p> <p><i>(Evidenca 2. Rregullore e brendshme e Universitetit "Luarasi", nr. 17-2023;</i> <i>Evidenca 135 : Rregullore e organizimit dhe funksionimit te NJSBC ; Evidenca 73. Raportet vjetore të NJBSC 2021-2022, 2022-2023.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht dukë rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve. Në rastet kur të dhënat kanë sensibilitet të lartë informacioni jepet në formë konfidenciale.</p> <p>Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet ëeb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p><i>(Evidenca 73. Raportet vjetore të NJBSC 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca 132. Raportet e pyetësorëve për çdo vit akademik)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit te akreditimit raportohen prane rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësite e tyre. <i>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson dhe inkurajon angazhimin e Instiucionit për të përmirësuar cilësinë përmes aktiviteteve të tilla sic janë trajnimet në aspektin didaktik, mbështëtja e sfafit në aktivitete shkencore etj por rekomandon që në <i>që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojnë më tej mekanizmat analitike të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për</p>	<p>GVJ nuk identifikoi veprimtari dhe informacione që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktivitetëve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>(Evidenca 143. Të dhëna statistikore lidhur me rezultatet e studentëve; Evidenca 73. Raportet vjetore të NJBSC 2021-2022, 2022-2023)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo semestri , të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efikasitetit të aktivitetëve me personelin dhe studentët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Luarasi”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i Studimit Bachelor në “Infermieri” organizohet dhe realizohet në një institucion me eksperiencë të gjatë në përgatitjen e studentëve në degë të ndryshme. Bazuar në strukturën organizative të konsoliduar, institucioni ka zgjeruar fushën e veprimtarisë mësimdhënëse me hapjen dhe organizimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.
2. Planet dhe programet mësimore janë hartuar në bazë të modeleve më të mira kombëtare, europiane e më gjerë duke respektuar standartet dhe kuadrin ligjor në fuqi.
3. Praktika është një pjesë e rëndësishme e planit mësimor në këtë program studimi. Marrëveshjet aktive të bashkëpunimit me institucionet shëndetësore publike dhe private bëjnë të mundur realizimin e praktikës dhe aftësimin profesional të studentëve duke punuar me raste klinike konkrete dhe duke manipuluar nën mbikqyrjen e drejtuesve të praktikës.
4. Institucioni ka bashkëpunim dhe marrëveshje me struktura universitare europiane e amerikane që kanë ndikuar pozitivisht në mobilitetin e stafit akademik, kualifikimin e tij, në implementimin dhe përmirësimin e kurrikulave, aplikimin e programeve të shkollave verore dhe trajnimeve profesionale për studentët.

Pika të dobta:

1. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në disa raste nuk përputhet me kërkesat ligjore. **(Standardi II.2, kriteri 1; Standardi IV.1 kriteri 2)**
2. GVJ konstaton se nuk përmbushet kriteri ligjor sipas të cilit 70% e ngarkesës mësimore duhet të mbulohet nga PAE. **(Standardi II.1 kriteri 2; Standardi IV.1 kriteri 2)**. Ka titullarë të lëndëve që nuk janë të kategorisë Profesor; disa nga titullarët janë me gradë Dr. ndërkohë që ka dhe titullarë me Msc. **(Standardi II.3 Kriteri 4)** Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizën dhe formimin e tyre profesional dhe disa lektorë me Msc. **(Standardi III.1 kriteri 4)**
3. GVJ konstaton se mungon laborator i dedikuar i infermieristikës i domosdoshëm për realizimin e plotë të praktikave infermieristike me mulazhe. **(Standardi IV.1 kriteri 5; Standardi IV.2 kriteri 3)**
4. Literatura e detyruar është e kufizuar në leksionet e shtypura të pedagogëve. Literatura e rekomanduar shqiptare dhe e huaj në përgjithësi është më e vjetër se 5 vjet. **(Standardi II.3 Kriteri 4)**
5. Fondi i limituar i bibliotekës për këtë program studimi dhe nevoja për përditësim të literaturës. GVJ evidenton që panvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar **(Standardi IV.3)**

Rekomandime:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1. GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës mësimore sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018.
2. GVJ inkurajon mbështetjen nga institucioni të stafit ekzistues PAE për përmbushjen e objektivave të kualifikimit për fitimin e gradave dhe titujve shkencorë.
3. GVJ rekomandon vazhdimin e investimeve në infrastrukturë dhe teknologji për të përmirësuar ofertën mësimore në fushën e infermieristikës. GVJ konsideron investim të domosdoshëm krijimin e laboratorit të dedikuar të infermieristikës me mulazhe dhe mjete të tjera specifike didaktike.
4. GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore të fushës së mjekësisë dhe shtimin e hapësirave të dedikuara për studim.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in “Nursing” offered by the Higher Education Institution “Luarasi University”

Strengths and affirmations:

1. The Bachelor's Degree Program in “Nursing” is organized and implemented in an institution with long experience in preparing students in various fields. Based on the consolidated organizational structure, the institution has expanded the field of teaching activity with the opening and organization of the Faculty of Medical Sciences.
2. The curricula and teaching programs are designed based on the best national, European and wider models, respecting the standards and legal framework in force.
3. Internship is an important part of the curriculum in this study program. Active cooperation agreements with public and private health institutions make it possible to carry out internships and professional training of students by working with concrete clinical cases and manipulating under the supervision of internship leaders.
4. The institution has cooperation and agreements with European and American university structures that have positively influenced the mobility of academic staff, their qualification, the implementation and improvement of curricula, the application of summer school programs and professional training for students.

Weaknesses:

1. The distribution of the teaching load in some cases does not comply with legal requirements. **(Standard II.2, criterion 1; Standard IV.1 criterion 2)**
2. EEG finds that the legal criterion according to which 70% of the teaching load must be covered by EAS is not met. **(Standard II.1 criterion 2; Standard IV.1 criterion 2)**. There are course heads who are not in the Professor category; some of the heads have a Phd degree while there are also heads with Msc. **(Standard II.3 Criterion 4)** There are lecturers who teach courses that do not match their expertise and professional training and some lecturers with Msc. **(Standard III.1 criterion 4)**

3. EEG finds that there is a lack of a dedicated nursing laboratory, which is necessary for the full implementation of nursing practices with models. **(Standard IV.1 criterion 5; Standard IV.2 criterion 3)**
4. Required literature is limited to printed lectures of the lecturers. Recommended Albanian and foreign literature is generally older than 5 years. **(Standard II.3 Criterion 4)**
5. Limited library funds for this study program and the need to update the literature. EEG highlights that despite the high number of titles, the medical literature was poor in titles and outdated **(Standard IV.3)**

Rekomandime:


1. EEG recommends adapting the teaching load according to the requirements set out in the Albanian legal framework.
2. EEG encourages the institution to support the existing EAS to meet qualification objectives for obtaining scientific degrees and titles.
3. EEG recommends continued investment in infrastructure and technology to improve the teaching offer in the field of nursing. EEG considers the creation of a dedicated nursing laboratory with models and other specific didactic tools as a necessary investment.
4. EEG recommends enriching the library with contemporary literature in the field of medicine and increasing the spaces dedicated to study.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X